


muhabete kafeje

MBI TRASHËGIMINË
DHE DIVERSITETIN



JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe



muhabete
kafeje



Përmbajtje



- 7 Mirënjohje
- 9 Parathënie, KE
- 11 Parathënie, BE
- 13 Hyrje
- 14 Inkuadrimi i 'të tjerëve'
- 16 Trashëgimia kulturore jomateriale: një koncept i njohur në mënyrë të çuditshme!
- 19 Një dilemë: shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore për turizëm apo shfrytëzimi i turizmit për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore?
- 23 Një frymë ajër të pastër: Ndërkulturalizmi, qytetet ndërkulturore, identiteti urban përballë konformizmit
- 26 Identitetet e shumëfishta të vetvetes
- 28 Dialogu dhe komunikimi: Ndërtimi i mesazheve në dialogjet moderne
- 31 Trashëgimia e përbashkët si përgjegjësi kolektive
- 34 Tregime nga vendi ynë
- 37 Trashëgimia dhe potenciali i fshehtë
- 41 Prishtina, aty ku rrugët nuk kanë emër!

Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët 'BE/KE - Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë'. Përmbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.



Mirënjohje



Ekipi i projektit PDKK dëshiron t'u shprehë mirënjohje një numri individësh të cilët vazhdimisht kanë treguar gatishmëri, përfshirje e angazhim në sesionet e dialogut.


Së pari, dëshirojmë ti përmendim veçanërisht sociologët, artistët, gazetarët si dhe individë të tjerë nga fushat akademike për çasjen konstruktive dhe profesionale ndaj projektit si dhe kontributet e vlefshme e opinionet inspiruese.

Një falendërim i madh shkon artistit Driton Selmani për punën e devotshme sa i përket vizatimeve të cilat i janë bashkangjitur artikujve.

Falendërimet poashtu shkojnë edhe për Jenna Shearer Demir, Crystal Whitaker dhe të tjerët të cilët kanë dhënë kontribute të rëndësishme në redaktimin e artikujve dhe rafinimin e tyre.

Përveç tyre, një mirënjohje i shkon edhe ndihmësit të komponentës për edukim në PDKK, Arif Muharremit, për koordinimin e të gjithë procesit.

Përfundimisht, dëshirojmë ti falendërojmë të gjithë individët të cilët kanë dhënë mbështetjen e tyre, kanë ndarë njohuritë, instruksionet dhe pikëvështrimet e tyre, dhe i kanë kontribuar kulmimit të suksesshëm të projektit.



Parathënie



‘Muhabete kafeje’ është proces i dialogut ndërkulturore për çështjet që janë në thelb të qëllimit të Këshillit të Evropës, siç janë: ruajtja dhe avancimi i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe të sundimit të ligjit. Përmes projektit theksohet rëndësia e të dëgjuarit të zërave të njerëzve në të gjitha komunitetet pavarësisht ideve dhe prejardhjeve të tyre të ndryshme. Në fakt, ky proces thekson vlerën e diversitetit, i cili promovohet në konventat dhe aktivitetet e Këshillit të Evropës.

Sesionet e dialogut janë organizuar në kontekst të Projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/ Këshillit të Evropës, të quajtur Përkrahja e Promovimit të Diversitetit Kulturor në Kosovë* (PPDK) me qëllim të nxitjes së të menduarit kritik për vlerat dhe interpretimet e ndryshme të trashëgimisë e rëndësisë së vlerësimit të diversitetit në Kosovën e sotme. Përmes projektit u krijua një platformë për vlerësimin e ideve dhe pikëpamjeve individuale në kuadër të një procesi dinamik dhe produktiv. Ky libër paraqet vet thelbin e një rrugëtimi arsimor të bërë nga individët brenda komponentëve të ndryshëm të shoqërisë në Kosovë mes viteve 2010-2012. Në kuadër të nismave të ndryshme të arsimit dhe të vetëdijesimit të projektit PPDK-së, sesionet e dialogut kanë mundur që palët e ndryshme me interes nga sektorë të ndryshëm të shprehën, gjë e cila ka qenë një nga parimet kryesore të projektit të PPDK-së. Ne jemi duke pro-

movuar në mënyrë aktive një qasje të integruar dhe shumëdisiplinore për një kuptueshmëri më të gjerë të trashëgimisë dhe të përkatësisë.

Nën patronazhin e programit regjional të Këshillit të Evropës në Evropën Juglindore, përmes projektit të PPDK-së janë zbatuar shumë aktivitete si ndihmesë për komunitetet dhe autoritetet në Kosovë, duke i përkrahur ato në të mësuarit dhe në pranimin e standardeve të pranuar evropiane për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë së përbashkët.


Këshilli i Evropës mbetet i përkushtuar nocionit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si mënyrë e kultivimit të parimeve bazë të të drejtave të njeriut dhe të demokracisë. Puna e projektit të PPDK-së është shembull i suksesshëm i nismës që promovon dialogun ndërkulturore për të siguruar më mirë përgjegjësinë kolektive dhe për të krijuar një mirëkuptim më të madh mes kulturave.

Njëkohësisht, dëshiroj t’i falënderoj shumë kontribuues të këtij libri që kanë ndarë mendimet dhe njohuritë e tyre profesionale, duke shpresuar që edhe lexuesit do t’ua shtojnë këtyre mendimet dhe veprimet e veta.

Robert Palmer

Drejtor i qeverisjes demokratike,
kulturës dhe diversitetit
Këshilli i Evropës

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Parathënie



Trashëgimia kulturore në mbarë Evropën njihet si instrument i identitetit kulturor. Mbrojtja e trashëgimisë sonë të përbashkët dhe promovimi i diversitetit kulturor janë po ashtu instrumente shumë të rëndësishme për afrimin e komuniteteve dhe për përmirësimin e dialogut mes kulturave të ndryshme.

“Muhabete kafeje”, të organizuara si pjesë e Veprimtimit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës – përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDKK)“ kanë qenë një shembull i jashtëzakonshëm se si dialogu na ndihmon të familjarizohemi me kulturën tonë dhe ta vlerësojmë atë, si dhe me kulturat e komuniteteve të tjera. Duke i bashkuar njerëzit me prejardhje të ndryshme për të diskutuar rreth temave relevante për trashëgiminë dhe diversitetin, këto muhabete gjithashtu kanë kontribuar në promovimin e një kuptueshmërie më të mirë të rolit dhe të rëndësisë së trashëgimisë kulturore.


Materialet e këtyre muhabetëve janë përmbledhur në broshurën “Muhabete kafeje”, duke na dhënë kështu një ide për reflektimet e mbi 100 individëve që

kanë marrë pjesë në sesionet e dialogut. Broshura ilustron në mënyrë të përkryer rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe të diversitetit përmes shumësisë dhe shumëllojshmërisë së mendimeve e të vizioneve të këmbëyer.

Ruajtja dhe promovimi i diversitetit kulturor janë ndër parimet bazë të Bashkimit Evropian, si dhe parim udhëzues i bashkëpunimit tonë me Kosovën. Duke stimuluar mendime dhe diskutime të tjera për këto çështje, shpresoj se broshura “Muhabete kafeje” do të kontribuon në kuptueshmëri më të mirë të rolit dhe rëndësisë së trashëgimisë kulturore, si dhe të fuqizimit të dialogut mes komuniteteve të ndryshme.

Samuel Žbogar

Udhëheqës i Zyrës së BE-së/
Përfaqësues Special i BE-së



Hyrje



Një filxhan kafe do të thotë shumë për ata që jetojnë apo kalojnë nëpër Kosovë, pavarësisht se prej nga vinë apo se ku shkojnë. Ta ftosh dikë në kafe është ftesë për t'u njoftuar më mirë me njëri-tjetrin, për të biseduar rreth proceseve, analizave, dekonstruktimeve, kritikave, thashethemeve, këmbimit të informatave, mësimnxënies, mësimdhënies; është ftesë thjeshtë për t'u angazhuar në dialog për çështjet që u interesojnë njerëzve.

Ajo çka mund të konsiderohet si 'humbje kohe' në disa kultura është në fakt kohë e nevojshme për rrjetëzim, kohë për shtjellimin e informatës dhe për të jetuarit e momentit. Thjeshtë, e tërë kjo nuk ka të bëjë vetëm me kafën, por me kohën që kalojnë duke pirë kafe, ku na jepet mundësia për shqyrtime të mëtejshme dhe të kuptuarit e aspekteve të rrethinës dhe çështjeve të rëndësishme për ta. Pavarësisht se cila është tema, muhabetet e kafesë shpesh janë të sinqerta, pasionante, joformale dhe përplot rrëfime të ndryshme.

Duke e respektuar këtë praktikë çdo ditë, projekti i PDKK-së ka organizuar një numër sesionesh dialogu në mes të individëve që kanë shfaqur interesim për t'u angazhuar në dialog për çështjet e rëndësishme për trashëgiminë dhe diversitetin. Në këtë kapacitet, individët nga fusha të ndryshme të jetës, duke përfshirë profesorë fakultetesh, mjekë, shërbyes civilë, artistë, interpretë, arkitektë, arkeologë, sociologë, punonjës ndërkombëtarë, studentë dhe mësimdhënës kanë marrë pjesë në sesione me grupe të vogla, ku kanë këmbyer pikëpamjet e tyre potenciale për temat e përzgjedhura në çdo sesion.

Me ndihmesën e punonjësve të PDKK-së, janë hartuar shënime nga çdo sesion në formë të një artikulli, me ilustrime përcjellëse të një artisti vendor

për secilin artikull. Me një pjesëmarrje mesatare prej 12 personash në çdo sesion, broshura "Muhabete kafeje" është pasqyrim i përafërsisht 120 individëve, të cilët në mënyrë të mirëfilltë kanë ndarë shqetësimet, interesimet dhe vizionet e tyre.

Përderisa çdo sesion ka qenë vetëm aktivitet intelektual, çdo artikull është produkt i individëve që kanë marrë pjesë në sesionet përkatëse dhe kanë kontribuar në hartimin e artikujve. Artikujt pasqyrojnë anëtarët e komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Përmes këtyre diskutimeve, ne shpresojmë të nxisim diskutime të tjera në mesin e qytetarëve me qëllim të ngritjes së mëtejshme të vetëdijes për trashëgiminë dhe diversitetin.

Pasi që dialogu është proces dhe ka një natyrë bashkëpunuese, është i rëndësishëm për ne sepse përmirëson komunitetin dhe ndërton kapitalin shoqëror, duke na nxitur kështu të mendojmë dhe të veprojmë në mënyra që do të ndikonin në përmirësimin e kushteve për të gjithë.

Në PDKK, ne ndjehemi të privilegjuar që kemi qenë në gjendje t'i bashkojmë këta individë në kafe, ku kanë marrë pjesë në një proces mjaft produktiv. Ne po ashtu jemi krenar që kemi pasur mundësinë të punojmë me artistë vendorë në publikimin e këtij libri, duke i kontribuar kështu të menduarit kritik me qëllim të ndryshimeve pozitive në shoqëri. Shpresojmë se do të kënaqeni duke lexuar "Muhabete kafeje" gjatë kafes me miq, kolegë dhe familje, si dhe duke këmbyer ide për krijimin e diskutimeve më të pasura me qëllim të krijimit të një shoqërie më të mirë.

Hakan Shearer Demir

Udhëheqës i ekipit të PDKK-së

Inkuadrimi i 'të tjerëve'



Në Kosovë ideja e diversitetit ka pësuar ndërsa është degjeneruar gjatë dekadës së shkuar, qysh prej se u soll në vëmendje publike si një kusht për bashkëekzistencë paqësore dhe pajtim. Megjithëse ky koncept ishte esencial për Kosovën e pasluftës, ai u ndie si i sajuar dhe i imponuar nga të huajt, duke shkaktuar rezistencë të brendshme dhe duke devijuar nga kuptimi i vërtetë i konceptit. Kuptimet të cilat u humbën në përkthim nuk i dhanë kohë publikut të gjerë për të analizuar dhe kuptuar fjalën në gjuhët lokale të Kosovës.

Termi 'diversitet' në gjuhën shqipe perceptohet si 'dallim'. Perceptohet sishumëllojshmëri e përfaqësimeve kulturore që identifikojnë kujtesën kolektive/historike. Megjithatë, shumë persona sot në Kosovë, prej fëmijëve deri te të moshuarit, përpiqen të kuptojnë pjesët e enigmës. Në tjetrën anë shihet një nevojë e madhe për një diskurs dhe mendim publik. Sidoqoftë, prania e diversitetit në shumë raste është shpjeguar si një imponim politik dhe një përfaqësim i tillë ka krijuar një numër të paragjyqimeve dhe stereotipeve.

Në të vërtetë, çfarë është diversiteti në Kosovë? Çfarë është ndërlihdja e tij me trashëgiminë kulturore? Cilat janë stereotipet e kosovarëve? Çfarë stereotipesh kanë kosovarët për të tjerët?

Kjo ishte tema e sesionit të parë të këtyre serive të dialogjeve të cilat u fokusuan në stereotipet e njerëzve rreth diversitetit dhe rolit të diversitetit në identifikimin e ndjesisë së përkatësisë në Kosovë. Ekspertët lokalë të lëmit të trashëgimisë, artistët, sociologët dhe profilet tjera kompetente nga Kosova u ftuan për të diskutuar dhe ndarë pikëpamjet e tyre mbi çështjen nga pikëpamja e tyre.


Cili dallim?

Në kontekstin lokal, diversiteti perceptohet si dallim derisa vihet në dyshim poashtu edhe prejard-


hja gjuhësore e terminologjisë. Konsiderohet si një ide e huaj e cila u sjell diçka të panjohur kosovarëve. Sidoqoftë, duke folur mbi diversitetin, dhe shprehur qartë, njeriu flet dhe mendon për llojllojshmërinë. Ka një mendim që thotë se diversiteti brenda komuniteteve të Kosovës perceptohet si një pasqyrim i përkatësive etnike dhe jo kulturave ndërsa pikëpamjet e jashtme e shohin territorin si një diversitet të kulturave komunitare. Kosova ka qenë historikisht viktimitë e stereotipeve dhe këto stereotipe janë modeluar politikisht - nga qarqet e ndryshme të interesit. Shpeshherë këto pikëpamje kanë çuar kah ndarjet etnike duke siguruar vazhdimësinë e lëvizjeve radikale nacionaliste tanimë në rritje. Manipulimi rreth diversitetit në vitet e 90-ta e vuri trashëgiminë kulturore në mes të ndarjeve etnike, e cila solli shkatërrimin e monumenteve ndërsa ka pasur një ndikim negativ në psikologjinë e kosovarëve.

Një nga mospërputhjet më serioze lidhur me çështjen e diversitetit në Kosovë mbetet inkuadrimi i kësaj terminologjie përbrenda kornizës politike, dhe si pasojë e kësaj edhe rryma kulturore ka neglizhuar promovimin e kësaj terminologjie brenda komuniteteve të Kosovës, duke e lënë të perceptohet se thekson diferencat etnike. Në kontekstin e Kosovës, diversiteti është një fjalë që nuk kuptohet plotësisht duke lënë kështu hapësirë të konsiderueshme për ide a koncepte të gabuara. Shkaktarët e këtyre ideve të gabuara janë kompleks ndërsa mungon aftësia për të sqaruar çfarë në të vërtetë diversiteti nënkupton botërisht dhe çfarë ai përfaqëson në gjuhën e popullit dhe në shembujt në kontekst të Kosovës dhe historisë së saj të fundit.

Ekziston poashtu edhe një mungesë e interesimit për të njohur kulturat tjera përmes aktiviteteve të vetëdijesimit sikurse dërgimi i nxënësve shqiptarë të Kosovës për ti parë ikonat e kishave ortodokse



Diversiteti kulturor dhe trashëgimia kulturore janë çështje joshëse dhe shumica e komuniteteve në Kosovë¹ e gjejnë veten në mes të këtij debati dhe nganjëherë madje fare lehtë. Projekti PDKK ka organizuar sesione të rregullta dialogu me artistët, akademikët, profesionistët dhe intelektualët vendorë të cilët janë të interesuar për shkëmbim të pikëpamjeve me kolegët e tyre, për të diskutuar dhe analizuar të përbashkëtat dhe ndryshimet nga të cilat formësohen vetë ata dhe të tjerët në Kosovën e sotme.



Këto sesione synojnë të sjellin në sipërfaqe pikë-pamje të ndryshme dhe të krijojnë një platformë ku publiku i gjerë frymëzohet të vazhdojë debatin publik mbi këto çështje.

serbe. Kjo vie në kundërshtim me gjeneratat më të vjetra, të cilat thonë se e mbajnë mend qartë kur, për shembull, ata kanë vizituar Patrikanën e Pejës çdo fundjavë dhe e kanë konsideruar si objekt të tyre kulturor derisa shumë të tjerë kanë pasur rastin të jetojnë në një lagje të përziera dhe kanë mësuar edhe një gjuhë të dytë.

Pa marrë parasysh, ka shumë punë për t'u bërë lidhur me çështjet e diversitetit brenda komuniteteve të Kosovës. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj pune është të sfidohet reduktimi i konceptit vetëm në përkatësi etnike. Ndarjet urbano/rurale janë shumë të dukshme dhe ndihen nga shumica e njerëzve në Kosovë dhe diversiteti i pasur i komuniteteve rurale duket të dëmtohet në emër të modernitetit. Këto ndarje dhe ndryshime janë më shumë të dukshme ndërsa përbërja demografike ndryshon, migrimi në zonat urbane rritet me një ritëm shumë të shpejtë dhe mospërputhjet dhe kujtesat e gjeneratave influencojnë perceptimet kulturore dhe ndryshimet në shoqërinë kosovare. Në dritën e të gjitha këtyre ndry-

shimeve të shpejta dhe duke kërkuar përmirësime, çfarë është vetë imazhi i Kosovës dhe çfarë imazhi do të dëshironin kosovarët t'ua përcillnin gjeneratave të ardhme?

Mbi evropianët e rinj

Më 2009, një kompani me famë ndërkombëtare ishte ngarkuar të bëjë një fushatë vizuale për paraqitjen e Kosovës në botë. Qëllimi i saj ishte të tregojë kapacitetin e Kosovës për investimet potenciale perëndimore dhe gjithashtu të përmirësojë imazhin e territorit në vendet që nuk e kanë pranuar pavarësinë e saj. Fushata "Evropianët e rinj", sollti ndjenja të përziera te popullata e Kosovës. Disa e shohin fushatën si një "limonadë" të përgatitur mirë e cila nuk përputhet me realitetin kosovar, por në të njëjtën kohë, ka një refleksim pozitiv për portretizim të llojllojshëm të të rinjve. Sipas disa mendimeve, ky prodhim vizual gjithashtu përmban një mesazh ironik, sepse diversiteti në Kosovë në nivele të ndryshme ishte i lënë pas dore. Kishte poashtu edhe disa keqardhje që projektuesit nuk kishin gjetur asgjë më të vlefshme për këtë prezantim të rëndësishëm. Në anën tjetër, perceptohet që fushata e thyen klishe për Kosovën si një rajon jostabil me konflikt të vazhdueshëm etnik. Dilema është se përmes kësaj fushate bëhet një përpjekje të krijohet një imazh rreth Kosovës i cili në realitet ka dështuar ta mbajë të vërtetën.

Ekziston rreziku që Kosova të bëhet monokulturore ndonëse synohet një shoqëri multikulturore nëse procesi nuk praqohet dhe udhëhiqet nga njerëzit me kuptim të qartë mbi vlerat universale që janë të përbashkëta për njerëzimin. Për Kosovën, duke shfrytëzuar analogjinë e mëparshme, çështja ka të bëjë me vetëdijesimin e të qenit një "limonadë të gatshme bukur e ambalazhuar" apo atij të kalimit përmes një procesi organik të përgatitjes së "ajvarit", i cili është lokal, i njohur dhe tradicional. Për ata që e njohin ajvarin, apo i kushtojnë kujdes, ka lloje të ndryshme për t'u shijuar.

Trashëgimia kulturore jomateriale: një koncept i njohur në mënyrë të çuditshme!



Trashëgimia kulturore jomateriale në Kosovë, me sfondin e saj të pasur, është duke kaluar nëpër kohë të vështira. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të ndikimeve të kulturës së përhapur globale dhe gjithashtu për shkak të mungesës së njohjes apo përqaimit të kulturave lokale në një nivel lokal.

Njohja e pamjaftueshme e vlerave tradicionale, duke përfshirë ritualet, vallet, këngët popullore si elemente thelbësore të shoqërisë së sotme çon kah largimi i mëtejshëm tek gjeneratat e reja, ku ndodh një ndryshim i paradigmes, dhe kështu kjo ka ndikim në qëndrimet ndaj trashëgimisë kulturore. Ndërsa shoqëria mbetet indiferente ndaj shkatërrimit të lokacioneve të trashëgimisë materiale, elementet e trashëgimisë jomateriale pësojnë më tej për shkak të mungesës së vetëdijesimit dhe edukimit të publikut të gjerë.

Mungesa e këtij vetëdijesimi kërkon një rrugë praktike për të sjell ndër mend dhe promovuar këto vlera brenda komuniteteve, veçanërisht tek gjeneratat e reja, të cilat janë elemente thelbësore për përcaktimin e qasjes ndaj trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Shkencëtarët që studiojnë shoqërinë, duke përfshirë etnologët dhe gjuhëtarët, bën studime kulturore në Kosovë për shumë vjet, duke dokumentuar zakonet lokale, praktikat kulturore dhe folklorin në botimet e ndryshme. Fatkeqësisht, ky proces kishte një ngecje të madhe gjatë të 90-ve kur trashëgimia jomateriale u la jashtë planit institucional të punës. Koncepti i trashëgimisë jomateriale u zhduk në mënyrë sistematike nga fusha akademike me territorin që po përballej me pasiguri politike dhe ekonomike në prag të shpërthimit të konflikteve në ish-Jugosllavi.


Në kohën e tashme, dokumentimi i trashëgimisë jomateriale në Kosovë nuk është as i mundshëm e as i arritshëm lehtësisht nga publiku i gjerë. Është e nevojshme të bëhet shumë punë në rrethet e lidhura me trashëgiminë kulturore, rrethet akademike dhe institucionet lokale për të ngjallur këto të dhëna.

Një sesion bashkëbisedimi i organizuar nga projekti PDKK mbi trashëgiminë kulturore jomateriale mblodhi në një vend ekspertët, artistët, akademikët, sociologët dhe profesionistët tjerë nga Kosova të cilët ndanë në mes vete qëndrimet e tyre dhe ngritën çështje që prekin këtë komponent të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Sesioni kishte për qëllim të sjell në sipërfaqe debatin mbi trashëgiminë kulturore jomateriale dhe të sigurojë një platformë në të cilën angazhohet aktivisht publiku i gjerë.

Gjithçka fillon me njohjen

Tradita gojore dhe folklori kanë qenë të pranishëm gjatë gjithë historisë së Kosovës dhe këto dy elemente luajtën një rol vendimtar në komunikimin e informatave të rëndësishme, historisë dhe ngjarjeve ndërmjet komuniteteve dhe gjeneratave. Shkalla e ulët e arsimimit dhe dinamika e stilit të jetës në zonat rurale e kufizuan mundësinë për të dokumentuar zhvillime të rëndësishme në formë të shkruar. Për pasojë, komunitetet përcollën ngjarjet e rëndësishme kombëtare dhe kujtimet e përbashkëta tek gjeneratat e reja përmes traditave gojore, duke përfshirë legjendat, këngët, proverbat dhe tregimet.

Traditat gojore kanë shërbyer gjithashtu si mjete për t'ua përcjellur vlerat kulturore gjeneratave të ardhshme si dhe mësimet e marra nga kujtimet dhe përvojat e përbashkëta, dhe luajtën rolin e urës lid-



hëse ndërmjet gjeneratave. Traditat gojore kanë pasur një efekt shumë pozitiv gjatë shekujve dhe gjithashtu kanë imponuar rregulla shoqërore dhe ligjore, sikur Besa dhe Kanuni të vjetra për rreth pesë shekuj, të citat u krijuan dhe ruajtën nga një institucion tradicional i quajtur odë.

Koncepti i “odës”, nëse konsiderohet si një mbledhje në një hapësirë apo një institucion tradi-

cional, është një vlerë e rrënjësor e trashëgimisë kulturore jomateriale në Kosovë. Oda paraqet, figurativisht, një hapësirë të veçantë dhe të veçuar të një shtëpie, e cila u dedikohet vetëm të moshuarve për të diskutuar çështjet e rëndësishme familjare, komunitare apo kombëtare. Veç kësaj, oda simbolizon gjykatën ku burrat mblidhen të diskutojnë dhe zgjidhin problemet e pronës, gjakmarrjet etj. Kjo hapësirë ishte gjithashtu një shesh i rëndësishëm i jetës shoqërore dhe kulturore dhe zbatimjes për burrat. Sot, pas shumë shekujsh të ekzistencës, “oda” ende është e gjallë dhe vlerësohet në komunitetet e caktuara në Kosovë.

Filozofi gjerman Walter Benjamin ndan kontributet e institucioneve tradicionale në dy nivele: anekdotat dhe zgjidhja e konfliktit, kur paraqet traditën gojore.

Në rastin e Kosovës, sa i përket nivelit të anekdotave, një botim i kohës së fundit tregon se si tregime të ndryshme odash të tregimtarit të famshëm gojor Xhemajl Obria kanë mbijetuar më shumë se 100 vjet në kujtesën kolektive, derisa ato përfundimisht u botuan.

Është e nevojshme të vërehet se pavarësisht nga dëshmia ekzistuese e trashëgimisë jomateriale e promovuar përmes odës, disa pjesë të shoqërisë i referohen këtij institucioni tradicional në kohën e shkuar. Për të tjerët, ende është një praktikë e jetës së tyre ditore dhe në disa raste i vendos nën hije ligjet ekzistuese moderne në Kosovë. Ndonëse ky dallim mendimesh mund të jetë ndoshta si refleksion i mënyrës urbane apo rurale të të menduarit në Kosovë, publiku i gjerë nuk duket se e njeh atë si pjesë të trashëgimisë jomateriale të territorit.

Me nënkuptimet e veta pozitive dhe negative, nocioni i odës mbetet një pjesë qendrore e një prej nënkulturave në Kosovë dhe e trashëgimisë së çmuar kulturore jomateriale. Një debat i mirëfilltë publik për t’a njohur atë si një vlerë kulturore dhe analizimi i rolit të saj në shoqëri janë thellësisht të nevojshme për të paraqitur rëndësinë që ajo ka në kushtet e sotme për shoqërinë.

Trashëgimia e lënë pasdore?

Favorizimi në fushën e trashëgimisë kulturore mund lehtë të çoj kah largimi dhe izolimi i grupeve të caktuara në shoqërinë kosovare. Pavarësisht nga ajo nëse është fjala për grup urban të marginalizuar apo grup tradicional rural, të gjithëve duhet t'u njihet e drejta për një vend të respektuar në shoqëri. Mënjanimi i ndonjëres prej këtyre nënkulturave do të krijonte në mënyrë të pashmangshme përplasje ndërmjet nënkulturave, pavarësisht nga sfondi apo origjina e tyre.

Asnjë kulturë apo nënkulturë nuk duhet përqeshur si dhe të emërtohet si “primitive”, “e keqe” apo “prapanike”. Trashëgimia kulturore jomateriale si një vlerë themelore e shoqërisë nuk duhet lënë pasdore dhe duhet të ketë vendin e vet të merituar në Kosovë, duke mos ekzistuar ndjenja e ndikimit të urrejtjes apo duke mos u bërë temë për shaka.

Rrënjët e lënies pasdore të trashëgimisë jomateriale në Kosovë na kthejnë në vitet e 60-ta. I ashtuquajtur i “Qarku Kulturor i Prishtinës”, i përbërë nga intelektualët më të njohur të kohës, nënshkroi një peticion i cili thërriste për bojkot të traditave të vjetra kulturore, duke përfshirë vallëzimet, folklorin etj, dhe të promovimit të tyre. Pesëdhjetë vjet më vonë, komunitetet në Kosovë e gjetën veten të ndarë ndërmjet praktikave të importuara kulturore të përqaftuara gjerësisht dhe traditave dhe zakoneve të vjetra gjysmë të braktisura. Anëtarët e komunitetit lokal për trashëgimi vërejnë se popullata e Kosovës ishte tërhequr në fushata të shumta që kërkonin zëvendësimin e vlerave tradicionale me ato moderne.

Kultura është një nocion dinamik dhe i nënsh-trohet në mënyrë të pashmangshme ndryshimit. Kombinimi i harmonishëm i të vjetrës me të renë e bën atë më të pasur dhe të çmueshme për gjeneratat që vijnë. Vlerësimi i trashëgimisë kulturore jomateriale dhe vlerave tradicionale të saj është imperativ për një paraqitje të mirë të së resë.

Esenca e arsimit në Kosovë duhet të theksojë rëndësinë e këtyre vlerave për gjeneratat e reja dhe publikun në përgjithësi dhe kështu të ngrisë vetëdijen mbi trashëgiminë kulturore jomateriale. Shoqëria civile

luan një rol shumë të rëndësishëm në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke arritur tek komunitetet dhe nxjerr në pah praktikatat e tyre kulturore dhe artizanatat. Vetëdija e ngritur brenda shoqërisë civile gjithashtu do të inkurajonte autoritetet lokale të ndajnë fondet e nevojshme për promovimin dhe mbrojtjen e praktikave dhe vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale.

Një qasje përfshirëse ndaj trashëgimisë kulturore me vëmendje të veçantë tek trashëgimia kulturore jomateriale, që inkurajon një partneritet publiko-privat me planifikim të qëndrueshëm afatgjatë ekonomik, do t'u jepte një mesazh pozitiv gjeneratave të reja në Kosovë dhe inkurajonte ato të marrin pjesë më tej në përpjekjet për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë së përbashkët.

Prej fjalëve në vepra

Shumë tema mbi trashëgiminë kulturore janë diskutuar në Kosovë. Mbrojtja së pari fillon me njohjen, pa e favorizuar një vlerë kulturore ndaj tjetrës, pasi të gjitha ato përfaqësojnë segmente të ndryshme të shoqërisë. Kjo njohje inkurajon një qëndrim konstruktiv për harmoni shoqërore dhe respektim të diversitetit. Një tregim i një të moshuari me përvojë jetësore shumëvjeçare, traditat dhe zakonet, njohja me dinjitet e gjeneratave të reja me këto vlera, është ajo çfarë e bën një komunitet krenar për historinë dhe të ardhmen e vet.

Një bashkëbisedim aktiv dhe përfshirës ndërmjet akademikëve, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve lokale dhe komuniteteve është imperativ për të gjetur një rrugë të përbashkët për të identifikuar, mbrojtur dhe siguruar mbijetesën e vlerave të pasura të trashëgimisë kulturore jomateriale në Kosovë.

Nuk duhet ekzistuar asnjë arsyeim për të shtyrë për më vonë këtë veprim për shkak të mungesës së fondeve apo gatishmërisë së palëve të përfshira. Është koha për të diskutuar në mënyrë aktive këtë çështje dhe “për të shtyrë përpara bisedën tonë”, para se të jetë tepër vonë për të shpëtuat atë që është duke humbur çdo ditë.

Një dilemë: shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore për turizëm apo shfrytëzimi i turizmit për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore?



Zhvillimi lokal është një proces që teorikisht vjen nga brenda. Meqë secili komunitet ka dinamikën dhe ritmin e vet të jetës, hapat progresivë¹ kërkojnë qasje gjithëpërfshirëse të analizuara mirë që marrin parasysh praktikat kulturore lokale. Praktikrat e importuara shpesh kopjohen pa një analizë të plotë dhe kanë prirjen të jenë jetëshkurtëra, e kjo shpie kah zhvillimi i padëshiruar dhe i paplanifikuar. Nga pikëpamja historike nga kjo kanë përfituar interesat e korporatës në dëm të resurseve, territorit dhe trashëgimisë së një komuniteti lokal.

Kosova, gjatë ndryshimit të rëndësishëm, e gjen veten një fazë zhvilimorë ku turizmi konsiderohet një vlerë esenciale. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka për qëllim që turizmi të përbëjë 10-12% të BPV deri në vitin 2020. Megjithatë ky objektivi ambicioz është inkurajues, ai gjithashtu ngrit një varg pyetjesh duke përfshirë atë nëse territori ka resurset, infrastrukturën dhe kapacitetin e nevojshëm për të arritur këtë qëllim, për të mos përmendur vizionin afatgjatë dhe strategjinë e shëndoshë për të qenë i qëndrueshëm. Caktimi i pritjeve të mëdha për progres mund të zgjerojë pozitivisht limitet e suksesit. Megjithatë, arritja e një qëllimi ambicioz me çdo mjet të nevojshëm mund të ketë pasoja, ndoshta të paparashikuara, shkatërruese.

Në njërën anë, do të ishte mirë të shohim se ky qëllim është arritur deri në vitin 2020, në anën tjetër, është esenciale të analizohen pasojat potenciale

dhe ndikimi në komunitetin lokal nëse, dhe si, arrihet ky qëllim. Kjo paraqet një sfidë të vështirë për autoritetet dhe komunitetet kudo në rajon dhe kërkon diskurs më të gjerë publik lidhur me atë se çfarë lloji të industrisë turistike Kosova pret në të ardhmen; të hapur për investime të mëdha të bëra nga elitat ndërkombëtare dhe lokale që përfitojnë nga resurset ekzistuese dhe shpesh lënë përfitim minimal për vendësit apo ndërmarrësi të bazuar në komunitet lokal ku resurset lokale shërbejnë për përfitim të komuniteteve lokale në një shkallë më të gjerë?

Rajoni i Pejës, me resurset e veta magjepsëse natyrore dhe pasuritë e rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, ka qenë në qendër të vëmendjes të aktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë gjatë dekadës së fundit si një vend ideal atraksioni për turistët (dhe ofron shërbime unike). Pasuritë e menaxhuara kujdesshëm të kombinuara me banorët vendës krenarë dhe mikpritës do të mund të paraqisnin një shembull pozitiv për pjesën tjetër të territorit dhe rajonin.

Mendimet dhe vizionet konstruktive sikur këto më lartë u diskutuan nga intelektualët të cilët morën pjesë në një sesion bashkëbisedimi të organizuar nga projekti PDKK. Përveç kësaj, një numër i sfidave me të cilat u ndeshën artizanët, anëtarët e shoqërisë civile, përfaqësuesit e biznesit, autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e grupeve minoritare gjithashtu u vunë në pah. Ngjarja u organizua në kontekst të aktiv-

¹ Në vitin 1960, historiani amerikan i ekonomisë, W. W. Rostow, sugjeroi që vendet të katojnë nëpër pesë faza të zhvillimit ekonomik.

iteteve të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane 2010 dhe kishte për synim të shqyrtojë promovimin e turizmit në lidhje me trashëgiminë kulturore në rajon dhe potencialin e tij për zhvillim ekonomik lokal.

‘Trashëgimia – Turizmi – Ekonomia’ si elemente esenciale të zhvillimit në Pejë janë lënë pas dore për një periudhë të konsiderueshme kohore. Në të kaluarën, lidhjet ndërmjet këtyre elementeve nuk janë krijuar si duhet dhe pjesëmarrësit e sesionit bashkërisht shprehën frustrimin e tyre për boshllëqet ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale. Ky frustrim qëndron në faktin se shumë mund të zbulohet pas një ngasje të shkurtër me veturë larg nga kryeqyteti: shëti të qeta në çarshinë e vjetër, hamami i Haxhi beut, xhamitë e rindërtuara, freskat mahnitëse në patrikanë, alpinizmi i nivelit botëror në bjeshkë/shkëmbinj, hulumtimi i shpellave dhe ushqimi i shijshëm vendas, pra të gjitha këto mund të shijohen në malet e Rugovës. Megjithëse rajoni ofron mundësi mahnitëse, mungesa e vizitorëve dhe ngurrimi i tyre për të përjetuar diçka nga rajoni është e çuditshme. Edhe më shqetësuese është se zona shpesh e qajtur nga komunitetet lokale si “lulja e bukur” e Kosovës perëndimore mund shpejt të zhduket për shkak të lënies pas dore, degradimit ambiental, shkatërrimit të lokacioneve të trashëgimisë kulturore dhe fundit të artizanëve.

Turizmi – një alegori për të festuar të kaluarën


Gjeneratat më të vjetra shpejtojnë për të kujtuar, dhe lavdëruar, të kaluarën e lavdishme të artizanëve të rajonit me shkathtësi unike që ishin gjerësisht të kërkuar, madje edhe në Dubrovnik. Përveç meritës artistike, këto punime kishin vlerë tregtare dhe sollën një burim të rëndësishëm të të ardhurave për rajonin duke siguruar qëndrueshmëri të bizneseve lokale të bazuara në vepra artizanale tradicionale. Arkitektura autentike dhe jeta përreth këtyre pasurive paraqitën një vlerë estetike unike e cila e dalloi rajonin nga pjesa tjetër e Kosovës. Mundësia e një plani që ndjek këtë model të suksesshëm, të ndërtuar përreth pa-

surive unike të rajonit, është duke u vënë në dyshim nga ajo që në mënyrë tipike konsiderohet si zhvillim apo progres.

Sistemi i vlerës të së kaluarës ka kontrast të madh me të sotmin dhe kjo shpesh mund të shihet në numrin e bizneseve turistike dhe artizanale që kanë dështuar në Pejë. Në ditët tona, nami i rajonit nuk i tërheq shumë turistë dhe ata që vizitojnë, kryesisht ndërkombëtarët që punojnë në Kosovë, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në ekonomi. Lokacionet e trashëgimisë kulturore janë duke pësuar ekonomikisht dhe mbijetesa e shumicës së artizanëve varet nga financimet e jashtme, si ato të komunave dhe donatorëve ndërkombëtarë. Artizanët tradicionalë janë duke u përballur me shuarjen meqë trendet e reja si bastoret dhe bizneset e kumarit të shkallës së vogël tërheqin gjeneratat e reja nga praktikat dhe vlerat tradicionale kulturore.

Pamja e ndryshueshme e qyteteve të pazakonshme sa i përket atraksionit siç është Peja, duke u ndryshuar me drita neoni dhe bastore, mund të konsiderohet si zhvillim ekonomik dhe gjithashtu mund të konsiderohen si hapa të nevojshëm për komunat për të tërhequr turistët. Megjithatë, opinionet jashtë komunave fajësojnë autoritetet se nuk kanë bërë mjaft për të mbrojtur lokacionet me vlerë të trashëgimisë dhe mbështetur bizneset lokale, tradicionale si mënyra për të inkurajuar turizmin. Përfaqësuesit nga shoqëria civile, duke përfshirë artizanët, u kërkojnë drejtuesve vendorë të krijojnë një strategji të shëndoshë dhe marrin hapa praktikë për të mbështetur bizneset dhe artizanët vendorë duke promovuar turizmin përmes heqjes së taksave.

Ndonëse autoritetet lokale janë shpesh nën vëzhgim të kujdesshëm, iniciativat e bizneseve lokale gjithashtu nuk janë premtuese. Shpeshherë mbështetja e tepërt në resurset e jashtme të limituara për të përkrahur vetveten paralizon përpjekjet e bizneseve për të krijuar strategji të shëndosha dhe promovuar/përfutur nga qasjet e qëndrueshme tradicionale lokale. Megjithëse duket se ka gatishmëri,



ka diçka që mungon për t'i sjellur të gjitha palët së bashku me një qasje bashkëpunimi për të ndërmarrë së bashku hapa konkretë. Kështu si qëndron puna, bisedat produktive mbi të ardhmen e zhvillimit të turizmit mund të zhvillohen vetëm nga të moshuarit nostalgjikë në kafene.

Çfarë të bëhet më tutje?

Në emër të modernizimit dhe progresit, gjeneratat më të reja duket të kenë braktisur një nga resurset më të çmueshme në Kosovë, trashëgiminë kulturore

dhe natyrore, e cila përfshin biodiversitetin e pasur dhe bukurinë natyrore, trashëgiminë e rëndësishme të ndërtuar, artizanatin, shkathtësitë në punë dore, zakonet unike tradicionale dhe muzikën dhe praktikat e ndryshme kulturore.

Ndonëse zhvillimet e reja të lidhura me krijimin e qendrave tregtare janë përhapur si këpurdhat në gjithë Kosovën, nuk ka pasur përpjekje të përbashkët për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë ekzistuese interesante. Vëmendja ka qenë e përqendruar në pronësinë e këtyre lokacioneve, duke lënë pas dore

mbrojtjen e profesioneve tradicionale dhe lokale që janë duke u zhdukur. Në një botë ku përparësia krahasuese është esenca e tërheqjes së turizmit, rajoni i Pejës dhe Kosova në përgjithësi duhet të jenë në gjendje të gjejnë identitetin e vet unik në Evropë duke ofruar elementet e veta esenciale, të cilat ekzistojnë vetëm ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë, dhe të shmangin rrugën e dëmshme të importimit të modeleve nga alpet zvicerane apo fshatrat austriake.

Duke qenë vetvetja, përmes gjetjes së vendit të vet unik, dhe duke vlerësuar përvojën e të moshuarve dhe energjinë e gjeneratës së re, Kosova mund të transformojë resurset ekzistuese lokale të pashfrytëzuara/pak shfrytëzuara në një ekonomi të qëndrueshme dhe të shëndoshë me mbështetje lokale ku njerëzit e rajonit vazhdojnë të jenë krenarë dhe fitojnë pagë të duhur për jetesë me dinjitet.

Ndonëse ekziston një qasje gjerësisht e përhapur për të bërë plane të mëdha dhe fituar para në mënyrë të shpejtë, mundësitë e vogla janë hapat vendimtarë që janë duke u humbur. Qasjet/ngjarjet modeste, sikur panairët në rrugë, inkurajojnë promovimin e produkteve siç janë veshjet tradicionale, qilimat, instrumentet dhe ushqimi si dhe gjithashtu vizitat në lokacione interesante. Pavarësisht nëse janë të vogla apo të mëdha, projektet që zbatohen në mënyrë sporadike, për shembull pa bashkërendim, janë të dënuara të mos kenë progres të duhur. Një zgjidhje e duhur dhe e qëndrueshme qëndron në zhvillimin dhe promovimin e turizmit lokal të bazuar në resurset lokale, me njerëzit vendës të përfshirë në procesin e vendimmarrjes të cilët përfitojnë drejtpërdrejtë nga të ardhurat/fitimet. Teorikisht, kjo bëhet me idenë e të menduarit globalisht dhe të vepruarit lokalisht, pasi traditat lokale dhe identiteti kulturor janë esenciale për komunitetet në Kosovë.

Përkrahja e marrë nga organizatat ndërkombëtare që nga viti 1999, ndonëse e çmuar shumë, nuk tregon

pozitiv të qëndrueshme për ekonominë e Kosovës. Pa marrë parasysh se këto fonde gradualisht janë duke u zvogëluar, autoritetet dhe bizneset lokale dhe artizanët duhet të jenë në gjendje të gjejnë zgjidhje praktike përmes inkurajimit efektiv të partneritetit publiko-privat. Ky bashkëpunim, me një strategji të qartë, do t'u mundësojë komuniteteve të vendosin se çfarë lloji të zhvillimit ata dëshirojnë të shohin përmes turizmit. Përveç kësaj, kjo do t'u jepte komuniteteve një mundësi të mirren me çështje esenciale që kanë të bëjnë me elemente të filla sikur çmimi social dhe kulturor i turizmit, roli apo trashëgimia kulturore në turizëm dhe elementet e nevojshme për të kuptuar një lidhje të shëndoshë ndërmjet trashëgimisë kulturore, turizmit dhe ekonomisë lokale në një rajon sikur Peja.

Pjesëmarrësit e sesionit pajtohen për sugjerimet vijuese:

-Të krijohet një mekanizëm i shëndoshë që do të promovonte trashëgiminë kulturore përmes bizneseve tradicionale lokale dhe të tërhiqen më shumë vizitorë për të përjetuar trashëgiminë natyrore të rajonit.

-Të krijohet një strategji që do të shfrytëzonte trekëndshin magjik të rajonit të Pejës: trashëgiminë e pasur, destinacionin turistik dhe zhvillimin ekonomik.

-Të bëhen përpjekjet strategjike dhe bindëse për të tërhequr donatorët dhe investuesit ndërkombëtarë.

-Të ngritet vetëdija e popullatës lokale për të kërkuar që qytetet në Kosovë të mos bëhen pika atraktive për të fituar lehtësisht para, sikur krijimi i kumarive dhe bastoreve, që zëvendësojnë identitetin e paçmueshëm kulturor të qyteteve.

-Të njihen artizanët dhe puna e tyre, duke bërë përpjekje për të bartur shkathtësitë e tyre te gjeneratat e reja, ku vendimmarrësit vendës udhëheqin ndryshimin për të mirë dhe paraqesin një shembull të mirë për pjesën tjetër të Kosovës dhe rajonin.

Një frymë ajër të pastër: Ndërkulturalizmi, qytetet ndërkulturore, identiteti urban përballë konformizmit



Kërkimi i dikujt për kreativitet dhe mënyra të ndryshme të qenies mund të nënkuptojë anarki për të tjerët. Në anën tjetër, përcaktimi i një rendi të caktuar të ditës në emër të rregullave dhe rregulloreve dhe ndërtimi i imazhit të një shoqërie multikulturore, nëse nuk del nga baza, mund të përfundojë me të gjitha elementet e strukturave monokulturore. Çështja është atëherë, të jemi të vetëdijshëm se kur dhe si kuptohet kjo gjendje dhe çfarë masash duhet të merren, duke ndaluar së pohuari se hapi nuk ka të bëjë asgjë me diskutimin.

Ndërsa gjatë tërë një dekade deri më tani dialogu ndëretnik ka qenë i vendosur si çështja numër një në rend të ditës në Kosovë, a kanë pasur njerëzit e Kosovës mundësinë të kenë dialog të brendshëm për t'i vlerësuar marrëdhëniet me mjediset e tyre dhe a kanë pasur mundësi që vetë t'i bëjnë të ditura vendimet rreth së ardhmes së tyre? Rreziku i një jete të fabrikuar që nuk kuptohet apo brendësohet mirë nga komunitetet bashkë me varësinë nga komuniteti ndërkombëtar apo diaspora mund të çojë kah një e ardhme e paqëndrueshme për komunitetet në Kosovë. Ndërsa punohet drejt një shoqërie multikulturore, vështirësitë e tanishme ekonomike dhe stilet e jetës të bazuara në konsumator, mund të çojnë kah ndarjet e dallueshme ndërmjet grupeve, duke çuar kështu kah largimi dhe izolimi i mëtejshëm i shoqërisë, bazuar në mjedis socio-ekonomike.

Prishtina, një qytet që akomodon përafërsisht një popullatë të Kosovës prej një çerek milioni, me dinamikën e vet, është në kërkim të identitetit të vet

urban me ndikimin e vet të tanishëm dhe subkulturave. Megjithatë ekziston ndoshta plani urban i autoriteteve lokale, ndjenja e kaosit urban është një ndjenjë e afërme për shumë njerëz. Në dritën e një peizazhi të ri urban të pasluftës që është duke u ndërtuar, improvizimi duket të jetë një praktikë e zakonshme, duke përjashtuar shpirtin dhe nevojat e komunitetit. Përderisa praktikave të kulturës qendrore dominuese janë duke u bërë normë, subkulturave të marginalizuara janë duke lulëzuar në zona të ndryshme, të cilat paraqesin peizazh të ri urban njerëzor dhe identitete urbane në Prishtinë. Nga jashtë dikush mund ta përcaktojë peizazhin urban me të gjitha grupet e dallueshme në Prishtinë, duke mos kuptuar se këto grupe e ndiejnë veten pjesë të identitetit kolektiv urban në Kosovë. A ka identitete të shumfishta brenda identitetit urban në Prishtinë apo ndoshta këto grupe të dallueshme pritet t'i përshtaten kulturës qendrore?

Të kuptuarit e subkulturave në një mjedis urban dhe krijimi i hapësirës për to për të ekzistuar, është esenciale për t'i respektuar pikëpamjet e njëri-tjetrit dhe diversitetin e identiteteve urbane. Mungesa e vetëdijes mbi ekzistencën dhe gjykimin e tjetrit rrezikon mbijetesën e natyrës së identitetit urban dhe e mban këtë nocion larg nga natyra interkulturore dhe e ndryshme e stilit urban të jetës, dhe kështu çon kah këndvështrimet monokulturore dhe shterpe. Mbijetesat e subkulturave të ndryshme është esenca e jetëve urbane ku kreativiteti, diversiteti dhe gatishmëria për bashkekzistencë bëhen normë për të gjithë që vlerësojnë identitetet urbane.

Në definimin e identitetit urban, a ka veprim kolektiv për të ruajtur natyrën e ndryshme të tij apo një numër i vetiniciativave të pavarura të vendosura së bashku për të krijuar mozaikun e këtij identiteti? Ndonëse ka një numër ankesash të paraqitura nga individët ndaj institucioneve, mungesa e iniciativave të organizuara qytetare vlen të përmendet. Në shumë qarqe mungesa e iniciativave dhe veprimit kolektiv shpesh mbetet mu si “bisedat e kafesë”. Qarqet e vogla të individëve zakonisht marrin veprime të vogla të kufizuara tek anëtarët e grupit dhe individët me mendim të njëjtë, dhe ata përsëri mbesin në zonën e rehatisë të kulturës së tyre.

Ndarjet urbane-rurale dhe gjithashtu ndarjet ndërmjet grupeve socio-ekonomike janë më të dukshme se kurrë më parë, duke paraqitur pengesë para integritetit potencial të grupeve të ndryshme, veçanërisht studentëve të universitetit. Grupet sub-kulturore shpesh preferojnë të qëndrojnë në grupet e tyre përkatëse, duke ruajtur idetë e tyre të caktuara rreth tjetrit dhe duke mbajtur veten të veçuar nga jeta urbane dhe çfarë ajo ka të ofrojë.

Një qytet me një çerek milioni banorë kërkon jetë të pasur kulturore ku diversiteti i saj është garantues për mbijetesë të aseteve të veta të pasura kulturore. Jeta e tillë kulturore sjell kënaqësi kolektive dhe kujtime të jetës dhe përkatësisë urbane. Shoqërive që u mungon jeta e tillë kulturore nuk kanë shumë për t'u ofruar gjeneratave të tyre më të reja të cilat janë të paracaktuara për mënyrën e tyre të ekzistencës larg nga ndryshimi potencial social. Politikat e jetës kulturore urbane dhe identitetet urbane janë elemente të rëndësishme për mirëqenie kolektive dhe gjithëpërfshirje. Ndonëse autoritetet lokale duhet marrë parasysh politikat e tilla, veprimi qytetar është imperativ për të mbyllur zbrazëtitë dhe për të punuar drejt një shoqërie të shëndetshme.

Veprimet e tilla duhet të jenë përgjegjësi e të gjithëve me qëllim që të jemi në gjendje të largojmë veten nga qëndrimet kundërshtuese dhe të marrim një rol aktiv në procesin e formësimit të identitetit

urban. Në kohë të ndryshimeve, jeta kulturore dhe diversiteti nuk duhet të braktisen dhe sakrifikohen nga politikat ditore konformiste të grupit dominues. Duket më mirë qëndrimi larg nga aparati i izolimit dhe të zgjidhet në vend të kësaj të sillen shoqëritë më afër. Komuniteti evropian është duke hapur dyert e veta për diversitet dhe globalizimi, është duke i sjell kulturat më afër, kështu që nuk do të ishte e mundshme të ndalemi në një shoqëri monokulturore.


Burimi i inspirimit – një rol i rëndësishëm në sistemin e besimit

A mund të ndryshojë politika mbi këtë çështje? A ka një kulturë të protestës proaktive në kulturën bashkëkohore në Kosovë apo protestat kushtëzohen dhe planifikohen për të mirën e përmirësimeve monokulturore? Çfarë janë sfidat e grupeve të marginalizuara të ndahen nga qarqet e tyre të vogla?

Nocioni i progresit mbetet shpesh i lidhur dhe i gabuar për gjërat sikur konstruksionet e paplanifikuara ndërtimore në qendër të qytetit, kurse të drejtat dhe cilësia e jetës për qytetarët injorohen. Vendim-marrja unanime dhe vizionet e imponuara kulturore për qytetin do të zgjerojnë vazhdimisht zbrazëtinë ndërmjet të gjitha grupeve të komunitetit. Këto masa të vazhdueshme rrisin mundësinë dhe potencialin për autoritarizëm kulturor dhe shfaqjen e qasjeve centraliste për sferën kulturore.

Progresi matet me katet e ndërtuara në qendër të qytetit. Humbja e kreativitetit individual dhe ekzistencës në emër të qenies së fabrikuar kolektive sakrifikohet në emër të disave.

Këto qëndrime do të lejonin uniformitet për të lartësuar e ndoshta aspiruar përfaqësimin e stilit të zakonshëm të jetës ndërmjet komuniteteve. Nëse është kështu, pyetja që shtrohet atëherë është nëse objektivi i tillë preferohet dhe përcaktohet nga komunitetet; apo, a ishte ai rendi i ditës i një grupi të vogël të vendimmarrësve për të krijuar aparatën e izolimit dhe mbyllin dyert në të njëjtën kohë kur bota është duke i hapur?



Identitetet e shumëfishta të vetvetes



Duke trajtuar dhe biseduar identitetet kulturore me qytetarët e Prishtinës dhe në veçanti trajtimin e “tjetrit”, këndvështrimet mbi temën ndryshojnë varësisht nga prejardhja e individëve, si: mosha e tyre, niveli arsimor, prejardhja familjare, cilësia e individëve për tolerancë dhe përvoja e tyre personale.

‘Tjetri’ në kontekstin e Kosovës perceptohet secili që nuk shfaq normat konvencionale të shumicës dhe popullatës së përgjithshme. Në këtë kuptim “tjetri” konsiderohet secili nga një grup i ndryshëm etnik dhe religjioz, orientim seksual apo me ndonjë shenjë të dalluar individuale të stilit jetësor jokonvencional. Siç u pajtuan anëtarët e grupit, Kosova, si çdo vend tjetër në botë, është e pasur me identitete të ndryshme kulturore dhe ekziston një nevojë e ngutshme për të nisur një katalizator të ndryshimit në perceptimin e këtyre identiteteve.

‘Toleranca e rremë’ quhet toleranca sipërfaqësore ndaj “tjetrit”, domethënë, tolerancë jodiskriminuese siç paraqitet në vijim:

‘Mua nuk më intereson nëse ti më pëlqen mua apo jo, por mua më intereson nëse do të më punësojë apo jo duke u bazuar në identitetet e mia personale (gjinore, etnike, religjioze etj.)’².

Në kërkim të njohjes ‘së tjetrit’, realiteti në terren nuk është premtues sipas shumë vetave. Paraqitja e ideve apo mënyrës së re të ndryshme të qenies shpesh has në refuzim indirekt përmes sjelljes jotolerante, e cila vetë manifestohet përmes mospërfiljes, demotivimit frikësues intelektual, duke ushqyer distancimin nga tjetri. Mendjengushtësia si e tillë mund të çojë kah sjellja fyese, e papranueshme dhe diskriminuese sociale.

Diskriminimi, bazuar në stereotipa dhe paragjykim, në kontekstin e Kosovës bazohet shumë më shumë në kontekstin nacionalist të ushqyer nga tregimet nacionaliste historike. Diskriminimi në

këto kushte, shihet si mburojë mbrojtëse apo madje patriotizëm, për mbijetesë nacionale dhe luftë kundër asimilimit kulturor. Në këtë kuptim, identifikimi i stereotipave diskriminuese në Kosovë nga komuniteti ndërkombëtar mund të jetë më i vlefshëm për shkak të potencialit të tyre për objektivitet dhe qëndrime neutrale.

Këndvështrimi nga guaska e breshkës

Nevoja për vetëreflektim dhe identifikimi i ndërtimit të stereotipave konsiderohet një pikë e mirë fillimi për çdo zhvillim të tolerancës brenda shoqërisë. Në kontekstin e Kosovës, ndryshimi i fuqisë balancohet ku komuniteti “i viktimizuar” dhe minoriteti i perceptuar i së djeshmes është tani komunitet dominues dhe jotolerant; ndërsa, grupi shumicë dhe dominues i së djeshmes paraqet komunitetin e perceptuar “të viktimizuar” të së sotmes. Ky ndërrim i roleve dhe këndvështrimeve u konsiderua si një pasojë e drejtpërdrejtë e ndryshimit social dhe ambienteve në të cilat njerëzit e gjejnë veten. Si pasojë, grupi i viktimizuar dhe grupi dominues krijojnë mite dhe stereotipa për njëri-tjetrin që nuk do të thotë domosdoshmërisht se reflektojnë fakte dhe janë potencialisht të anshme.

Aspekti tjetër social që nuk ndihmoi në inkurajimin e kuptimit të ndërsjellë kulturor dhe tolerancës në shoqërinë e Kosovës, është imponimi ndërkombëtar i asaj që është quajtur “multietnicitet” apo Kosovë multietnike. Ideja e komuniteteve ndërkombëtare për multietnicitetin doli nga koncepti perëndimor mbi multietnicitetin bazuar në përvojat dhe rrethanat e tyre. Megjithatë, njerëzit në Kosovë nuk e kanë konsideruar shpesh njëri-tjetrin si grupe multietnike, sepse nacionalitetet që jetojnë në Kosovë kishin shumë më shumë të përbashkët sesa komuniteti ndërkombëtar mund të imagjinonte, pavarësisht


“Pasi që temat merren me identitete të ndryshme dhe të shumëfishta në përgjigje të konteksteve sociale në të cilat ato gjejnë veten në momentin e caktuar...”¹.

¹ <http://science.jrank.org/pages/7777/Multiple-Identity.html>
[qasur më 10 shkurt 12]

² Anëtar nga grupi i diskutimit

dhunës së luffërave në ish-Jugosllavi në vitet e 90-a. Prandaj, pavarësisht të gjitha qëllimeve të mira, qasja e komuniteteve ndërkombëtare rreth multietnicitetit u perceptua tepër moralizuese pa lejuar më shumë hapësirë për t'u zhvilluar toleranca bazuar në traditat dhe praktikat lokale në nivel lokal, dhe kështu u parandalua të ndodhin proceset e mirëfillta të pajtimit.

Besohet që ekziston një mungesë e përgjithshme e vetëreflektimit dhe vetëkritikës në Kosovë që potencialisht mund t'i kontribuonte dekonstruktimit të miteve dhe paragjykimeve rreth "tjetrit" dhe lejimit të mirëkuptimit të ndërsjellë kulturor dhe kërkimit të ngjashmërive më parë se dallimeve. Veç kësaj, situata e dobët ekonomike në Kosovë nuk ndihmon zhvillimin e tolerancës pasi ajo bëhet një mjet i lehtë për të fajësuar shpesh "tjetrin" për varfërinë dhe mungesën e prosperitetit.



Të tjerët nga planeti diaspora

Izolimi dhe integrimi mjaft i kufizuar i diasporës kosovare që jeton në Evropën Perëndimore, veçanërisht në Gjermani, Zvicër dhe Britani të Madhe është i lartë. Shkalla e ulët e integritimit në Gjermani dhe Zvicër shpjegohet me mjete më të pakta financiare dhe më pak kualifikime arsimore, shpesh referuar për Kosovën rurale. Siç është parë ndër grupet e tjera imigruese, (p.sh. irlandeze, greke dhe komuniteteve të tjera imigruese), diaspora e Kosovës gjithashtu adoptoi një sjellje sociale proteksioniste dhe vetizoluese me qëllim të ruajtjes së identitetit nacional me tendencë për nacionalizëm dhe patriotizëm të shtuar.

Megjithatë, diaspora kosovare, për shkak të afërsisë me vendlindjen shkon një hap më tutje në ruajtjen e identiteteve të tyre nacionale, domethënë, sigurimit që të rinjtë të marthohen me partnerë nga Kosova-nëse ata nuk mund të gjejnë partnerë të përshtatshëm nga komuniteti i tyre i diasporës. Kështu, bëhet një shaka lokale gjatë muajve të verës kur vendësit shohin veçanërisht meshkujt nga diaspora duke vozitur automobilet e tyre të shpejtë flakërues që tregojnë "vlerën" e tyre në kërkim të një nuseje nga Kosova. Diaspora kosovare që jeton në Britani të Madhe konsiderohet, gjithashtu, më e integruar në shoqërinë britanike, meqë ata vijnë nga mjedise shoqërore më të arsimuara dhe rrjedhimisht me më shumë të punësuar, ambicioz dhe të arsimuar në Britani, gjithashtu.

Sjellja izoluese sociale e diasporës kosovare që jeton në Evropën Perëndimore shkakton frustrim ndërmjet komuniteteve në Kosovë, duke e lidhur këtë me vështirësitë e përjetuara drejt integritimit evropian, tolerancës dhe zhvillimit ekonomik në BE. Me qëllim të të kuptuarit "të tjetrit", njeriu duhet të provojë të kuptojë dhe pranojë qenien njerëzore me zemërgjerësi dhe kuriozitet dhe të shmang izolimin dhe largimin. Gjithçka fillon me pranimin e tjetrit dhe bërjes përpjekje për t'u njohur më mirë. Komunitetet në Kosovë kanë qenë të njohura me këtë me shekuj, duke ofruar mikpritjen e tyre dhe një filxhan kafe.

Dialogu dhe komunikimi: Ndërtimi i mesazheve në dialogjet moderne



Kalimi nga mënyra tradicionale e të menduarit në sisteme më liberale dhe bashkëkohore të vlerave konsiderohet të jetë proces thelbësor tranzicional, dhe në të njëjtën kohë formon ide dhe besime të reja për kosovarët.

Bashkë me këtë, edhe shoqërisë gjithnjë e më shumë po i duhet që të përshtatet me etikën dhe normat e reja, duke asimiluar parimet e njohura dhe globale.

Rrjedhimisht, të bëhesh pjesë e këtij shpirti të kohës (Zeitgeist) është gjithnjë e më shumë diçka e zakonshme. Kjo gjë konsiderohet të jetë instrument i progresit social, proces ky i integritimit kulturor në kulturën perëndimore.

Megjithatë, praktika e ndarjes kulturore, ndarjes në klasa dhe e stereotipive dominon në media dhe diskurse publike, dhe me këtë ngritet tendenca e paragjyqimeve dhe e kontribuit ndaj perceptimeve të gabuara rreth kulturave të tjera, gjë që shpije në forma të getoizimit social dhe kulturor.

Si pasojë e këtyre klasifikimeve të përgjithshme, format e përditshme të komunikimit të bazuara në këto etiketime kulturore tani më janë bërë mangësi kulturore ku njerëzit gjithnjë e më shumë janë të prirë të grupohen sipas agjendës së përpiluar sipas llojeve sociale të përkatësisë që i shërben elitave politike dhe grupeve të fuqishme ekonomike.

Si ndërtohet dialogu në shoqërinë bashkëkohore? Kush e përpilon agjendën e medieve masive dhe format e komunikimit? Kujt po i drejtohet këto porosi, dhe çka është qëllimi i tyre?

Në këtë seancë janë paraqitur dhe diskutuar pikëpamjet e individëve prominentë në shoqëri, duke u përqendruar në llojet e dialogut dhe të komunikimit

si mjet për ndërtimin e pikëpamjeve kulturore dhe sociale dhe për të përkufizuar ndikimet e tyre në qasjet ndaj komunikimit sot.


Mediet formësojnë pikëpamjet rreth 'Jashtëfokësorëve' tanë

Nga perspektiva e zakonshme, roli i komunikimit dhe i platformës për dialog perceptohet si instrument për ngritjen e bashkëpunimit ndërkufitar dhe për themelimin e rrjeteve profesionale. Më e rëndësishme është se ai përdoret si instrument për arritjen e tolerancës ndërkulturore dhe mirëkuptimit të dyanshëm.

Megjithatë, në kontekstin lokal, llojet tradicionale dhe patriarkale të komunikimit ende dominojnë diskurset e shoqërisë – lloje të cilat ende janë posaçërisht të theksuara në mjedise rurale dhe në mesin e gjeneratave më të vjetra. Ndonëse institucioni tradicion dhe rural i odave është duke e humbur rëndësinë në mediet, korniza e diskurseve në shoqëri dhe medie nuk ka përjetuar ndonjë ndryshim themelor apo ndonjë progres të jashtëzakonshëm.

Një shembull që demonstroi se shumë komunikime bazohen në paragjyqime është sjellja e shoqërisë ndaj komunitetit të diasporës. Shoqëria dhe mediet kanë një pikëpamje të përbashkët rreth komunitetit të diasporës si "punëtorë të paedukuar të ndërtimitarisë" të cilët injektojnë financiarisht ekonominë vendore. Përveç kësaj, një pikëpamje vendore shumë e përhapur është se ata janë beqarë që vishen keq, të cilët marrim me qira vetura luksoze për të tërhequr femrat vendore.

Në anën tjetër, komuniteti i diasporës e sheh si të vështirë përfaqësimin e paanshëm përmes platfor-



mave të medieve lokale në mënyrë që të konfrontojnë klishe vendore dhe përgjithësimet rreth identitetit të tyre të tanishëm dhe përfaqësimit kulturor.

Ekzistojnë disa raste ku mediet qëllimisht shfaqin qasje diskriminuuese, duke ilustruar dhe theksuar ndarje nëpër shtresa dhe paragjykime. Disa emisione të njohura televizive, për shembull, paraqet-

sin kushtet e dobëta të jetesës, por neglizhojnë kodin e tyre etik të gazetarisë për ofrimin e portretit të plotë; ku në këtë mënyrë ato nuk e respektojnë qasjen neutrale për përfaqësimin e dinjitetit njerëzor, duke rritur njëkohësisht perceptimet për dallimet në klasat shoqërore mes aktorëve të tyre dhe audiencës. Shumë besojnë se ndarja nëpër shtresa dhe

sipas kulturës siç paraqitet nganjëherë nëpër medie paragjykohef dhe bëhet qëllimisht. Ndikimi dhe agjendat e tyre kanë ndikim negativ në komunitetet dhe kulturat, duke shpërfillur nevojat e komunitetit në kërkim të një tregimi që fuqizon më tej keqkuptimet e zakonshme.

Ka edhe nga ata që besojnë se komunikimi kulturor e inkurajon këtë fabrikim meqë mjetet e medieve që përdoren nga grupe të ndryshme të interesit qëllimisht dëshirojnë të lavdërojnë, distancojnë dhe krijojnë diskurse të njëanshme në sferën publike.

Kryqëzimi i 'kolegut'

Marrëdhëniet kolegiale në vendet e punës, kryesisht nëpër institucionet publike, shpeshherë bazohen në aleanca të klikave të caktuara, duke krijuar një kulturë të varësisë personale në vend të asaj të zhvillimit të marrëdhënive profesionale.

Kjo tendencë nuk lejon zhvillimin profesional dhe ka ndikim mbi produktivitetin e individëve nëpër vendet e punës; për shembull, mosmarrëveshjet mes kolegëve nuk ndodhin për shkak të diskurseve intelektuale apo paradigmave të ndryshme, por për shkak të nevojës për të mbrojtur aleancat dhe grupet e caktuara të interesit.

Si rezultat i kësaj, është zhvilluar një shprehi e nepotizmit, gjë që është e barabartë me korrupsion në vend të punës, dhe që është karakteristikë e zakonshme në institucionet publike. Ndonëse nga një perspektivë e huaj duket se shoqëria kosovare është duke u përpjekur që të largohet nga kornizat tradicionale të komunikimit, ky tranzicion ka ngecur meqë diskursi i jetës së përditshme ende ka tendencë të bazohet në paragjykime dhe aleanca.

Në procesin e rivlerësimit të standardeve sociale dhe të reflektimit rreth nevojave aktuale, disa zëra theksojnë se shoqëria ende është në proces të riformatimit të imazhit të saj, ku në të njëjtën kohë i duhet që të përballlet me problemet afatgjata. Rrëfimet e ndryshme historike që vazhdojnë të ndërtojnë qasje negative drejt 'të tjerëve' ende janë një nga burimet kryesore të paragjykimeve dhe stereotip-

izimit, dhe trajtimi i këtyre çështjeve të rrënjëzuara me siguri do të ishte çelësi i ndryshimit.

Zgjidhja arsimore e edukativ

Sistemi arsimor mbetet një nga burimet më të rëndësishme të identifikimit dhe ndërtimit të mënyrave të komunikimit. Në këtë drejtim, ende mbetet shumë për t'u bërë.

Manipulimi i historisë, proces ky që fillon mu në shkollën fillore, ka krijuar një mentalitet të njëtrajtshëm dhe të përgjithshëm që pasqyron qasjen ndaj komunikimit në mesin e kulturave dhe komuniteteve.

Rrjedhimisht, ka shumë nevojë për një reformim të sistemit arsimor – në veçanti në revidimin e librave të historisë – si proces i nxitjes dhe ngritjes së kapaciteteve të nxënësve për të menduarit kritik dhe vetëreflektim, si dhe për përshtatjen e tyre me qasjet ndaj komunikimit mes kulturave dhe komuniteteve të tjera.

Komuniteti ndërkombëtar ka investuar shumë për zhvillimin e Kosovës pas luftërave të viteve të nëntëdhjeta, si për shembull në aspektin e infra-strukturës, politikës dhe proceseve të demokratizimit. Megjithatë, prioriteti i tanishëm është nevoja për reformimin e arsimit nga shkolla fillore deri në nivelin universitar, në mënyrë që të dalin individë kritikë dhe me mendje të hapur e mundësi të vetkritikës, me aftësi të fuqishme objektive profesionale dhe qasje etike.

Arsimimi, si mjet për njohjen e vetvetes dhe të tjerëve, duhet të inkurajojë të menduarit kritik dhe shumëdimensional, të bazuar në mësimdhënie logjike dhe konstruktive, pra, komunikim dhe rrëfime të bazuara në fakte dhe jo në përralla.

Ndonëse mbështetja e komunitetit ndërkombëtar në këtë çështje është esenciale, Kosova që tani duhet të përballlet me sfidat e saj në fushën e arsimit dhe t'i vejë ato në prioritet. Përmes kësaj mase, dialogu bashkëkohor brenda komuniteteve dhe mes tyre, në vend dhe ndërkombëtarisht, do të mund të vendoset në nivelin e ardhshëm.

Trashëgimia e përbashkët si përgjegjësi kolektive



Vlerat kulturore kanë qenë gjithmonë pjesë e trashëgimisë, identitetit dhe kujtesës tonë kolektive. Trajtimi i trashëgimisë si përgjegjësi kolektive nuk ishte i njëjtë gjatë gjithë historisë, megjithatë, gjatë dekadave të fundit në Kosovë, qëndrimet ndaj ruajtjes së trashëgimisë së përbashkët nuk kanë ndryshuar dukshëm.

Kohët e fundit, ndërsa njerëzit janë më të vetëdijshëm mbi rrethinën dhe ambientin e tyre, komunitetet shohin prishje të ndërtesave që kanë kuptime kulturore dhe janë pjesë e kujtesës sonë kolektive. Shkatërimi i ndërtesave të trashëgimisë nga disa, pa marrë parasysh kuptimin e tyre, moshën dhe afë çfarë ato paraqesin për historinë tonë, shpesh mbulohet me kujdes minimal apo pa kurrfarë kujdesi për të parandaluar shkatërrimin e tyre.

Fatmirësisht, ende ka grupe të vogla të qytetarëve të përkushtuar dhe organizatave që bëjnë përpjekje të mbrojnë trashëgiminë ekzistuese kulturore në Kosovë dhe kundërshtojnë politika jokonsistente që prekin monumentet e identitetit urban.

Sa i përket turizmit dhe trashëgimisë kulturore, zakonisht të dyja kanë qenë të lidhura në mënyrë të pandashme. Njerëzit vizitojnë vendet për ndërtesat, historitë që ato ofrojnë për shkak të vlerës së tyre kulturore dhe të trashëgimisë. Prandaj, nevoja për të promovuar trashëgiminë kulturore që si pasojë do të kishte ndihmën për zhvillimin e turizmit kulturor është esenciale. Së bashku me ndërtesat e trashëgimisë, turizmi kulturor u mundëson vendasve t'i promovojnë traditat e tyre lokale, produktet kulturore, ritualet dhe mënyrën e të jetuarit me dinjitet, duke kthyer krenarinë e njerëzve për vendin dhe traditat e tyre.

Trashëgimia dhe institucionet

Janë së paku pesë institucione në Kosovë të cilat

merren me trashëgiminë kulturore. Detyrat e tyre kryesore janë të menaxhojnë konservimin, restaurimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Megjithatë, përmbushja e detyrave lidhur me mbrojtjen dhe qasjen ndaj trashëgimisë kulturore në praktikë, duke përfshirë artefaktet dhe materialet e shkruara, është e diskutueshme. Trajtimi i trashëgimisë kulturore nga banorët shpesh nuk është në nivelin e dëshiruar për shkak të mungesës së vetëdijes rreth trashëgimisë së tyre apo perceptimit të përhapur për trashëgiminë si diçka e vjetër prandaj edhe e pavlerë.

Shumë kohë humbet në debatet rreth asaj se kush dhe cili autoritet do të marrë përsipër mbrojtjen e ndërtesave të caktuara ndërsa në ndërkohë ndërtesat janë lënë të dëmtohen. Mjaft shpesh, konservimi i ndërtesave bëhet pa garanci të cilësisë dhe standarde të duhura, dhe kështu lejohen improvizimet që nuk paraqesin karakterin dhe qëllimin e vërtetë të ndërtesave dhe nuk mbrojnë ekzistencën e tyre për gjeneratat e ardhshme. Këto improvizime zakonisht janë bërë për përfitime politike, p.sh. në linjë me fushatat zgjedhore dhe për paraqitje pozitive në medie. Paaftësia për të ruajtur trashëgiminë kulturore zakonisht lidhet me zhvillimet e rindërtimit të pasluftës që përqendrohen në gjenerim të ardhurash dhe zhvillim ekonomik. Argumenti i konservimit është shumë më i kushtueshëm sesa zhvillimet e reja ndërtimore dhe kjo nuk është duke ndihmuar mbrojtjen e trashëgimisë por siguron zgjidhje në kurriz të shkatërrimit të trashëgimisë së përbashkët.

Kujtesa kolektive lu nënshtrohet politikave qeverisëse të qeverive

Mediet sociale, interneti dhe lojërat paraqesin një sfidë të drejtpërdrejtë për të siguruar që shoqëria dhe

veçanërisht të rinjtë qëndrojnë në harmoni me kulturën e tyre dhe vlerat e trashëgimisë. Ndërsa këto zhvillime mund të mbajnë rininë larg nga trashëgimia e tyre, kjo mund të jetë një mundësi për të përfshirë vlerat e trashëgimisë kulturore në botën virtuale të internetit dhe mediet sociale.

Në kontekstin e Kosovës, trashëgimia kulturore vlerësohet duke u bazuar në vlerat e saj estetike dhe kujtesën kolektive. Megjithatë, duke pasur parasysh nevojat ekzistenciale dhe prioritare të popullatës në Kosovë, ku njerëzit duhet të brengosen për nevojat e tyre të përditshme, ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore nuk shihet si prioritet kryesor i shumicës së popullatës.

Në Ballkan, për shkak të shumë ndryshimeve në qeverisje politike, trashëgimia kulturore u trajtua si një mjet ose për të bërë përpjekje për të fshirë historinë, sa i përket të pretenduarit të fitores së tanishme mbi sunduesit e mëparshëm; ose si përpjekje për të ringjallur atë në përpjekjet për të pretenduar prejardhje me një periudhë të caktuar të historisë, megjithëse mjaft shpesh pa fakte të forta historike. Regjimi i mëparshëm la pasoja të drejtpërdrejta në trashëgiminë në Kosovë, në veçanti trashëgiminë e Prishtinës për shkak të politikës së tyre për të shkatërruar të vjetrën për hir të së resë. Për shkak të kësaj politike, për shembull, gjithë qytetit të vjetër Prishtina iu vu buldozeri për të lejuar hapësirë për ndërtesa të stilit të ri. E reja dhe progresi në ish-Jugosllavi ishte çimentoja dhe betoni krahasuar me ndërtesat e vjetra tradicionale nga druri dhe balta.

Përpjekjet e kohës së fundit për të rishkruar historinë pasjugosllave është e rëndësishme të përmenden, meqë ka pasur përpjekje për të hequr qafe trashëgiminë e lidhur me kohën jugosllave, për shembull monumentin e bashkëm-vëllazërimit në Prishtinë. Ideet për zëvendësimin e këtij monumenti me një park veturash janë atraktive për disa qarqe. Në të njëjtën linjë, investimet e mëdha në ndërtime për të pretenduar prejardhje të vjetër greke për kombin e vet përmes ndërtesave dhe statujave të reja në Shkup janë interesante për t'u përmendur. Kjo tregon që

politika mbi trashëgiminë në Ballkan ndryshon me çdo qeveri, dhe si e tillë trashëgimia kulturore zotërohet nga qeveritë qeverisëse dhe nuk trajtohet si diçka që u takon të gjithëve.

Trashëgimia dhe turizmi

Në Kosovë është bërë pak në promovim të trashëgimisë kulturore për të zhvilluar turizmin. Disa iniciativa, institucionale dhe të pavarura, u treguan si joefektive, jokreative dhe si të tilla këto iniciativa nuk arritën të tërheqin turizëm të konsiderueshëm lokal dhe madje edhe më pak turizëm ndërkombëtar në atraksionet kulturore. Në anën tjetër, organizatat ndërkombëtare në Kosovë bënë përpjekje të rëndësishme për të krijuar një platformë për zhvillim të politikës mbi trashëgiminë kulturore. Përmes projekteve dhe iniciativave të ndryshme, organizatat ndërkombëtare kanë arritur të inkurajojnë prodhimin e zejeve lokale dhe shpërndarjen dhe shitjen e tyre përmes panagyreve rajonale. Kjo, si rezultat, inkurajoi vlerësimin për zejet tradicionale lokale dhe ngriti vetëdijen e njerëzve rreth traditave të tyre dhe deri në një masë trashëgimisë së tyre kulturore.


Vendet e tjera në rajon bënë pak më shumë për implementimin e strategjive për turizëm dhe trashëgimi kulturore; disa rezultuan me trashëgimi konkrete dhe atraksione turistike sikur zhvillimi i Popova Kullës.

Mediet dhe arsimit

Mungesa e mbulesës së medieve dhe vendimarrja unanime e autoriteteve mbi trashëgiminë kulturore nuk u ka dhënë hapësirë qytetarëve për përfshirjen dhe njohimin e tyre rreth fatit të monumenteve të tyre kulturore.

Sa i përket arsimit, ka një zbrazëti të rëndësishme në sistemin arsimor të Kosovës në lidhje me trashëgiminë kulturore. Tema trajtohet pamjaftueshëm dhe në mënyra shumë jokreative gjë që nuk ndihmon në rritjen e vlerësimit për vlerat e trashëgimisë kulturore te gjeneratat më të reja.

përket vlerave të trashëgimisë së përbashkët dhe (mungesa e) përgjegjësisë kolektive në Kosovë mund



të shihet si një kombinim i paaftësisë së kufizuar institucionale, paaftësisë së qytetarëve për të pasur ndikim në vendimmarrje dhe implementim dhe mungesës së përkrahjes edukative për ngritjen e vetëdijes mbi trashëgiminë kulturore.

Gjetja e balancës dhe caktimi i prioritetit nuk është gjithmonë punë e lehtë, por duket e rëndësishme t'i

kontribuohet një të ardhme prosperuese duke investuar në gjeneratat më të reja. Thuhet se një pikturë ka vlerë prej një mijë fjalësh, por çfarë ne mund t'u themi gjeneratave tona të ardhshme kur nuk do të ketë tre-gjime për të rrëfyer përveç qytetit tonë të mbushur me ndërtesa të larta qelqi.

Tregime nga vendi ynë



Gjërat e para në vend të parë: kjo nuk është fontanë dëshirash me gjërat që të tjerët presin t'i shohin në Kosovë në vitet e ardhshme. Ky artikull përfaqëson një listë të pritshmërive të pjesëtarëve të komunitetit ndërkombëtar që jetojnë në Kosovë, kur paramendojnë ndonjë vizitë pas 20 vitesh.

Në mediet ndërkombëtare, Kosova kryesisht portretizohet si vend i trazuar, dhe njerëzit nga jashtë kanë pasur shumë pak raste që të dëgjojnë apo të lexojnë gjëra që tregojnë dhe shfaqin jetën e pasur kulturore të këtij këndi të vogël të Ballkanit. Megjithatë, komuniteti ndërkombëtar që ka punuar në Kosovë kanë pasur rastin që të zbulojnë sekretet e bukura dhe të ruajtura mirë të Kosovës.

Por, realisht, çka shpresojnë të shohin ata nëse do ta vizitonin Kosovën në të ardhmen me familjet e tyre? Ju mund t'i paramendonit ata: të veshur me rroba të përditshme duke rikujtuar kohërat që i kanë kaluar në Ballkan, kujtime të rastësishme; netë modeste, bohemiane në Tingell Tangell; fundjavë ecjesh në Rugovë dhe skijim në Brezovicë ...

Paramendonit se si na pëlqejnë turistët botërorë dhe një e ardhme të ndritur në Kosovë, realiteti për momentin nuk është edhe aq i ndritur.

Episodet e seancave të dialogut me intelektualët të organizuar nga projekti PDKK kanë vazhduar me një seancë të posaçme, të organizuar mes anëtarëve të komunitetit ndërkombëtar të cilët punojnë dhe jetojnë në Kosovë, dhe të cilët janë më të angazhuar në dhënien e kontributit në fushat e trashëgimit, kulturës, arsimit dhe mjedisit.

Ky dialog është projektuar për të zbuluar perspektivat e pjesëmarrësve dhe vizionet e tyre rreth Kosovës kur ata do ta vizitojnë Kosovën në të ardhmen – nëse e vizitojnë.

Aspirata për të qenë qendror


Çështja e parë që është ngritur ishte se 'për të qenë realist për të ardhmen, së pari duhet të verifikohen potencialet dhe mundësitë e të ardhshmes'. Nga kjo perspektivë, vizualizimi i të ardhmes së përfaqësimit lokal kulturor të Kosovës nuk është i qartë pavarësisht potencialit në rritje e sipër për një skenë kulturore dinamike.

Megjithatë, ajo që theksohet janë ndryshimet që priten në angazhimin për ngritjen e vetëdijesimit rreth trashëgimisë kulturore. Në mënyrë ideale, pas njëzet vitesh, ka shpresa se vendet e trashëgimisë do të jetë të qasshme për të gjithë komunitetet, dhe se zhvillimi i planifikuar për rreth atyre vendeve do të integrojë trashëgiminë në jetën e përditshme të shoqërisë dhe qytetit.

Është një shaka që thotë 'Udhëtimi nga Prishtina për në qytete të tjera është si të udhëtosh në makinën e kohës'. Në këtë aspekt, promovimi kulturor i rajoneve të tjera përbën një detyrë të madhe. Organizimi i ngjarjeve artistike me qëllim të ndërlidhjes së njerëzve dhe kulturave do të kontribuojnë në ngritjen e profilit të rajoneve të ndryshme meqë aktualisht ngjarjet kulturore kanë tendencë të përqendrohen në kryeqytet.

Përveç këtij centralizimi të kulturës, një çështje tjetër që është ngritur është prodhimi i produkteve dhe i ngjarjeve kulturore. Komunitetet lokale shfaqin mungesë pronësie për kulturat dhe traditat e tyre, meqë në praktikë çdo ngjarje kulturore mbështetet nga organizatat ndërkombëtare. Gjithsesi që këto ngjarje zakonisht mbahen në Prishtinë, duke filluar nga financimi, inicimi dhe zbatimi i projekteve deri tek mbajtja e ngjarjeve.

Por financimi i kulturës gjithnjë është i pasigurt, meqë për çdo shfaqje që shkruhet duhet të bëhet pagesë dhe është vështirë të vizualizohet shpagimi



në 20 vite, apo trashëgimia që lihet nga ajo. Në periudhën afatgjate, çështja është nëse shoqëria ka mundësi të mbështesë financiarisht dhe të krijojë aktivitete kulturore. Varshmëria në mjete nga jashtë nënkupton se momentalisht ka pak sinjale pozitive për një skenë të qëndrueshme kulturore dhe të artit në Kosovë.

Megjithatë, Kosova do të ishte në një skenar tjetër nëse do të përjetonte zhvillim solid ekonomik gjatë 20 viteve të ardhshme, që do t'i mundësonte njerëzve të shihnin përtej 'frigoriferit të mbushur' dhe mundësinë që t'i dedikonin kohë angazhimeve për proceset dhe zhvillimin kulturor.

Promovimi i traditave dhe i gjithëpërfshirjes gjithnjë është pjesë e zhvillimit kulturor, meqë së pari kërkon kapacitete të shtuara në arsim dhe investim në brezat e ri. Fatkeqësisht, kjo gjë ende nuk ka ndodhur në Kosovë.

Meqenëse skena kulturore në Prishtinë mund të jetë frymëzuese, duket se ajo zhvillohet vetëm atje. Ndonëse 'kultura' nuk është institucion i fuqishëm dhe pjesë e qasshme e jetës së përditshme, tani më

ekziston një skenë alternative plot jetë – dhe brenda një periudhe 20 vjeçare, ka shpresa që kjo të lulëzojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të jetë mishëruar në mënyrë natyrore në jetën e përditshme të shoqërisë, me autenticitetin e vet si produkt kulturor i zhvilluar në mënyrë organike.

Megjithatë, turistët e së ardhshmes së Kosovës nuk janë aq entuziastë për prospektet e saj në turizëm. Edhe pse idetë për zhvillimin e turizmit janë gjithnjë në rritje, Kosova asnjëherë nuk do të jetë pikë madhështore turistike ndërkombëtare, kryesisht për shkak se ajo është e rrethuar nga shtetet që tani më kanë strategji të zhvilluara mirë dhe dobiprurëse për të tërhequr vizitorë. Ajo që mundet të shpreson të bëjë është që të kapitalizojë burimet që i ka, dhe të inkurajojë vazhdimin e tyre në të ardhmen për qytetarët e vendit ashtu si dhe për vizitorët.

Zhvillimi i qëndrueshëm është një çështje tjetër brengosëse e cila duhet të ketë progres të dukshëm gjatë 20 viteve të ardhshme, dhe për të cilën qeverisja thuhet të ketë udhëhequr drejt një 'regresi', me efekte të tërthorta në mirëqenie. Skandalet e

korupsionit, nepotizmit dhe të keqmenaxhimit kanë fuqizuar mendimin se ata që udhëheqin Kosovën nuk po i marrin parasysh idetë dhe aspiratat e rinisë energjike të vendit.

Megjithatë, pritet të ketë gatishmëri kolektive për të reflektuar për pakënaqësinë e akumuluar përgjatë viteve dhe për të bërë ndryshime në të gjitha shtresat e shoqërisë.

Të qenit mjedisor

'Kryeqyteti i mbeturinave i Ballkanit' është mënyra se si një radio lokale i referohet Prishtinës. Me të gjitha përpjekjet e kryeqytetit të Kosovës për të gjetur rrugën e saj në hartën e vendeve që duhet të vizitohen, deri më tani janë ndërmarrë vetëm hapa orientues për përmirësimin e imazhit të qytetit dhe për vetreflektim. Në perceptimin e të huajve, 'njerëzit këtu gjithmonë e gjejnë dikë tjetër për t'i fajësuar për gabimet apo dështimet e veta'.

Bashkë me problemet e menaxhimit të mbeturinave dhe një qasje joefikase ndaj çështjeve mjedisore, vetëm pak hapa janë ndërmarrë për të parandaluar që zonat urbane t'i përngjajë favelave të ndërtuara ilegalisht dhe me rrugë me qelq prej pasqyrës. Duhet të ndërmerren hapa radikalë për të normalizuar planifikimin hapësinor dhe urban të çdo qyteti në Kosovë. Në këtë aspekt, mungesa e hapësirave publike shihet si një nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e veprimtarive efektive dhe gjithëpërfshirëse të të rinjve dhe potencialit të saj për zhvillimin dhe nxitjen e jetës qytetare.

Niveli i vetëkritikës mbetet në nivel të ulët, meqë llogaridhënia si nocion ekziston vetëm në letër. Shumica e proceseve dhe projekteve të institucionalezuar iu shërbejnë agjendave politike, që zbatohen me konsideratë të pakët për transparencë apo drejtësi.

Nevoja për një qasje nga poshtë lartë mbetet një nga prioritetet në mënyrë që të lirohet potenciali vendor dhe të ofrohen mundësi apo raste për ata që duan të kontribuojnë në normalizimin e jetesës – dhe të hapësirave të jetesës – në Kosovë.

Megjithatë, shpresat mbesin tek potenciali që do të mund të sillte revitalizimi i bujqësisë së Kosovës. Inkurajimi i bujqësisë, shoqëruar nga ndryshimet draslike në strategjitë bujqësore dhe politikat mbështetëse për bujqit, shihen si burim i shpresës për stabilizimin e ekonomisë lokale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Summa summarum

Në mesin e vizitorëve ndërkombëtarë ekziston një pritshmëri e përgjithshme që qytetarët do të marrin një rol më proaktiv në vendimmarrje dhe se do të ketë prosperitet efikas ekonomik për të mbështetur atë angazhim. Fuqizimi i popullit përmes ideve është diçka që inkurajohet, meqë tani besohet se 'kultura e fshatarëve' e ka pushtuar Kosovën dhe se elita politike nuk e përfaqëson frymën urbane.

Në këtë kontekst, roli i shoqërisë civile është i fuqishëm – dhe tejet i nevojshëm për të filluar me lëvizjen përpara të proceseve demokratike si dhe për ngritjen e përfshirjes dhe të integritimit social që, deri më tani, janë vërejtur shumë pak.

Qasshmëria dhe llogaridhënia janë të dukshme si nevojë për përparimin e shoqërisë dhe lëvizjen përpara me integrim të vërtetë. Në këtë aspekt, promovimi i diversitetit kulturor dhe qasja gjithëpërfshirëse në vendimmarrje është jetike.

Porosia e qartë është se promovimi i potencialit dhe i burimeve vendore është i mundshëm vetëm përmes investimit në to, dhe në këtë aspekt, për të tejkaluar stagnimin duhet të ndryshohen shumë gjëra.

Një gjë është e sigurt: ajo për çka do të vijnë turistët e ardhshëm të shohin në Kosovë mbetet e paparashikueshme. Kjo e tëra varet nga përkushtimi i qytetarëve dhe i komuniteteve për t'i funksionalizuar gjërat. Megjithatë, përpjekjet vazhdojnë të ngrisin perspektivat e çdo komuniteti në çdo fushë përmes shënjestrimit të arsimit, kulturës dhe ekonomisë. Në fund të fundit, do të varet nëse komunitetet vendore e shohin potencialin e burimeve të veta si gotë gjysmë e zbrazët – ose, faktikisht, si shumë e mbushur.

Trashëgimia dhe potenciali i fshehtë



Koncepti i gjerë, siç është 'kultura', sjell në tryezë përkufizime dhe pikëpamje relativisht të ndryshme, varësisht nga historiku, arsimimi, mjedisi kulturor dhe ndikimet kulturore të pjesëmarrësve të diskutimeve. Trashëgimia kulturore, megjithatë, është çështje më specifike, e cila inkorporon fushëveprim të gjerë të domethënies që zgjojnë kujtime: nga tradita e piteve të gjyshes, tek ndonjë grumbull gurësh në ndonjë kodër, e gjer tek ndonjë ndërtesë apo lokacion fetar.

Ajo që është më e ndërlikuar është lidhja e trashëgimisë me varfërinë, meqë në listën e prioritetëve të jetës së përditshme, ushqimi dhe nevojat themelore janë gjithsesi tejte më të rëndësishme.

Në anën tjetër, edhe përpjekjet e vazhdueshme për të promovuar vendet e pasura dhe të ndryshme të trashëgimisë kulturore janë gjithashtu prioritet. Por pyetja shtrohet se Në çfarë liste të prioritetëve bëjnë pjesë ato?: në listën e komuniteteve apo në atë të institucioneve?

Sesioni i nëntë i dialogut të projektit PDKK, që është mbajtur në Graçanicë, kishte për qëllim humlumtimin e lidhjeve mes 'trashëgimisë dhe varfërisë'. Aktivistët e OJQ-ve, akademikët, artistët dhe mbështetësit e të drejtave të njeriut janë angazhuar në një diskutim për shkëmbimin e mendimeve dhe përvojave nga ajo fushë.

Diskutimet rreth kësaj teme rezultojnë në interpretime të gjera dhe të ndryshme për shkak se në esencë vet tema e trashëgimisë, si dhe e varfërisë është e gjerë. Është me rëndësi që të bëhet kujdes në përpjekjet për përkufizimin e terminologjisë dhe

të koncepteve që zakonisht i karakterizojnë këto dy tema; sikurse që varfëria mund të kuptohet si nocion ekonomik, intelektual, shpirtëror, kulturor apo moral, edhe trashëgimia mund të klasifikohet nëpër kategori të prekshme, të paprekshme dhe natyrore. Në shumë raste, përpjekjet për caktimin e përkufizimit të vendosur të 'trashëgimisë' dhe 'varfërisë' kalojnë nëpër disa nga këto koncepte përgjatë një spektri. Në kontekstin vendor, varfëria dhe trashëgimia plotësojnë njëra-tjetrën, me ndikim tek njëra-tjetra në aspektet pozitive dhe negative dhe me ndikim në cilësinë e jetës dhe perspektivat e komuniteteve vendore.

Vrimë e zezë financiare

Gjatë viteve të fundit, Kosova ka marrë numër të konsiderueshëm të donacioneve. Megjithatë, territori vazhdon të ketë probleme domethënëse ekonomike që ndikojnë dhe formësojnë idetë, pikëpamjet dhe besimet në mesin e komuniteteve vendore. Janë të shpeshta raportet vendore dhe ato ndërkombëtare për keqpërdorim të mjeteve, keqmenaxhim të projekteve dhe keqpërdorim të detyrës në të gjitha nivelet e administratës.

Rrjedhimisht, varfëria ekonomike (financiare) është çështja dominuese në shoqëri, me indikacione të mungesës së kuptimit dhe mundësisë së duhur të zhvillimit të potencialit të trashëgimisë kulturore.

Për shkak të nevojës për përmbyshjen e nevojave të tyre themelore, komunitetet janë duke prioritetizuar aspektin e bollëkut në vend se të përqendrohen në shfrytëzimin e burimeve të ndryshme kulturore, natyrore dhe/ose ato alternative. Qasja aktuale është

e dukshme në marrëdhënien 'vetëshkatërruese' që qenia njerëzore në përgjithësi ka me mjedisin natyror dhe zonat e gjelbëruara.

Në kontekstin social, mungesa e investimeve në sistemin arsimor, si dhe mungesa e zotimit institucional për mbështetjen e arsimit dhe investimit në të ardhmen në përgjithësi, pasqyrojnë se trashëgimia dhe kultura – dhe lidhja e tyre me varfërinë – shpërfillet në masë të madhe. Ikja e trurit, kërkimi i një cilësie më të mirë të jetës dhe zhvendosja/risistemimi i detyruar kanë rezultuar në varfëri intelektuale dhe burime njerëzore profesionale të pamjaftueshme në fushën e kulturës, që rrjedhimisht kanë mundur dhe inkurajuar angazhimin e individëve të papërvojë dhe të paafësuar në këtë fushë.

Përgjegjësia e pamjaftueshme e institucioneve është vetëm një nga shumë faktorët që po ngadalësojnë procesin e ngritjes së vetëdijes së komuniteteve. Mediet diktojnë 'trendët' sipas agjendave të ndryshme politike, dhe për shkak të varësisë së shoqërinë nga mediet, vëmendja ndaj prioriteteve kulturore, siç është trashëgimia, po neglizhohet. Edhe paragjykimet ekzistuese kulturore dhe sociale iu japin ngjyrë pikëpamjeve të tanishme rreth trashëgimisë dhe diversitetit kulturor. Në veçanti, motivimi i të rinjve për t'u angazhuar në iniciativat kulturore mungon. Është e qartë se ekziston një nevojë e lartë për programe arsimore dhe informative që do t'i mundësonin komuniteteve një kuptim më të mirë të rëndësisë së ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe potencialit për zhvillimin e komuniteteve përmes burimeve të trashëgimisë dhe të kulturës.


Stereotipizimi gjithashtu ruan rol. Mungesa e njohurisë së konceptit të 'fqinjtit' ka shpjerë në pasqyrimin e gabuar të 'komunitetit tjetër', meqë trashëgimia kulturore zakonisht ndahet në 'tonën dhe 'të atyre'. Përpjekjet për të madhëruar një komb kundër tjetrit


janë në progres, me rezultat të ekzistimit të pabarazisë së dukshme në rëndësinë relative të një lloji të trashëgimisë kulturore ndaj tjetrës.



Megjithatë, ku flasim për pasuritë kulturore (diversiteti i kulturave, artefaktet, vendet, ndërtesat dhe traditat), jo vetëm në Kosovë, por në tërë rajonin e Ballkanit, vije në pah diversiteti i tyre. Shumica e komuniteteve që jetojnë në Evropën juglindore nuk i njohin këto asete si burime të zhvillimit intelektual dhe ekonomik. Përderisa në shtetet e tjera më të 'zhvilluara', trashëgimia kulturore ruhet dhe mirëmbahet mirë, në Ballkan ajo është djegur dhe rrënuar. Ajo që është më alarmante është se ky trend negativ ende është karakteristikë e zhvillimit bashkëkohor urban dhe 'modernizimit' shoqëror. Kosova nuk është përjashtim në këtë aspekt.

Pamjaftueshmëria e nismave kolektive dhe mungesa e vullnetit për komunikim janë duke penguar bashkëpunimin mes komuniteteve në lidhje me ruajtjen e trashëgimisë së përbashkët dhe promovimin e diversitetit kulturor. Bashkëpunimi mes komuniteteve është shumë domethënës për të siguruar zgjidhje afatgjate për parandalimin e efekteve negative të varfërisë dhe efekteve negative mbi trashëgiminë. Nevoja për vetëreflektim, ngritja e vetëdijes dhe përfshirja e të rinjve në këtë proces është jetike për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, që si rezultat mund të sigurojë se ajo mund të përdoret si mjet i fuqishëm kundër varfërisë dhe për të siguruar që trashëgimia nga e kaluara të përcillet tek brezat e ardhshëm.

Është e dukshme se rajoni është i pasur me diversitet të aseteve kulturore. Megjithatë njerëzit mbesin të varfër, të pavetëdijshëm për pasurinë që i rrethon ata. Popujve në Ballkan nuk ju nevojitet llapma e Aladinut. Ata e kanë atë. Ata vetëm se duhet ta fërkojnë atë për ta lëshuar fuqinë.







Prishtina, aty ku rrugët nuk kanë emër!



Hapi im i parë në çdo destinacion të ri është të blejë një udhërrëfyes dhe t'i mësojë rrugët rreth hotelit ku qëndroj dhe vendeve ku kam takime, ku shpeshherë i kopjoj dhe i zmadhojë hartat e rrugëve të zonave më të rëndësishme. Edhe dalja në përdorim e hartave nga Google nuk ka bërë që ky zakon të ndryshojë. Unë ende e çmojë faktin që udhërrëfyesit mbushin skeletin e zbrazët të hartave. Unë i lexoj pikat kryesore që rekomandohen për vizitorë, si dhe ato që janë më pak të njohura që zgjojnë interesimin tim. Kur arrij në hotel dal për një shëtitje sa më shpejt që është e mundur, shikojë peizazhin e vendit dhe orientohem me anë të hartave, shenjave të rrugëve dhe pikave të referimit. 'Magjia e rrugës është përzjerje e rrugëtimit në to dhe e emërtimit të tyre' thotë Rebecca Solnit në librin e saj 'Wanderlust: A History of Walking / Dëshira për të parë: Histori e ecjes.'

Vizita ime e parë në Kosovë këtë vit fillimisht i ngatërroi ata hapa të parë. Nuk ka dyshim se Kosova ende ka shumë punë për t'u bërë destinacion i njohur turistik, kështu që udhërrëfyesit ishin të rrallë. Por dy javë para se të nisesh për misionin tim të parë, në mars të vitit 2011, në librarinë tonë lokale Waterstones hasa në një kopje të vetme të një udhërrëfyesi të shkruar jashtëzakonisht mirë nga Bradt. I shkruar mirë, po, por harta rrugore e Prishtinës që ishte në të ishte si po të ishte hartë e Botës së Re para zbulimit. As vërejtja në tekstin nën pjesën 'Si të gjindesh' 'Getting Around' nuk më entuziazmoi: fillonte me - 'Sfida më e madhe në Prishtinë është kaosi relativ kur është fjala për emrat e rrugëve'. Siç duket ata janë ndryshuar pas çdo përmbyse/rrëmuje politike: shumë rrugë tani kanë tre emra në përdorim, por kjo nuk vlen për shenjat ekzistuese nëpër qoshe të rrugëve; ndoshta ato janë në pritje të rrëmujës së radhës!

Kështu që unë bredhja me kujdes, duke lexuar nga afër rrugët aq thellësisht siç do të lexonte një gjurmues i indianëve autoktonë sipërfaqen e shkretëtirës. Ndërtesat dalluese ishin të pakta, por më ranë në sy grumbujt e dyqaneve - argjendar pas argjendari në një rend të gjatë,

pastaj një grup prej tri barnaforeve, dhe pastaj prapë një grumbull dyqanesh të rrobave të femrave. Dhe në fund një rrugë e tërë e dyqaneve të rrobave të femrave, shumë nga të cilët mbanin fustane nusërie të gjatë dhe të stolitur të çdo ngjyre të mundshme. Për mua ky është peizazhi urban dallues dhe i mrekullueshëm i Prishtinës. Gjersa shëtisja më tej nëpër qytet pashë se ky tipar, ky grupim, vazhdonte: dyqane të pajisjeve në një vend, punëtori të llamarinës në një vend tjetër. Çuditëshe se pse.

Ditën e ardhshme gjersa ishim në vizitë në Pejë dhe Gjakovë vizituam vendet e Pazarit të Vjetër, ku më parë mjeshtër, zejtarë, artarë, nalbanë, marangozë, farkëtarë dhe rrobaqepës kishin punuar dhe kishin bërë tregti. Ato vende ishin djegur gjer në themele gjatë vitit 1999. Ato janë rindërtuar...në një mënyrë, por pak nga mjeshtërit dhe zejtarët janë kthyer; shumë nga rrugët e ngushta ende kanë një lloj zbrazëfire të mbytur. Jam i sigurt (së paku shpresoj të jem) se me kalimin e kohës brezat e ri të zejtarëve do t'i mbushin rrugët. Sfida tani mbetet menaxhimi i procesit në një mënyrë që mundëson vazhdimësinë e peizazhit kulturor dhe urban.

Ai ishte vendi ku gjeta përgjigjen e misterit tim të 'grumbullit të dyqaneve të fustaneve'. Çdo rrugë në treg kishte nga një zeje apo biznes të lidhur së bashku nga tradita e esnafit të saj. Dyqanet e Prishtinës e sigurojnë vazhdimësinë e kësaj karakteristike dalluese të peizazhit urban. Rrugët mund të mos kenë emër, por Bono dhe grupi U2 në Kosovë do të frymëzoheshin shumë për këngët e tyre.

Autorët e udhërrëfyesit paralajmëronin se 'Prishtina nuk është vend me të cilin do të mund të binit në dashuri në shikim të parë'. Mbase jo, por gjersa bredhsha nëpër atë pejzash dallues, me plot ngjyra dhe të gjallë, mendova se ndoshta dashuria që djeg ngadalë është dashuria që zgjatë - ajo më e vërteta.

Terry O'Regan

Shënim

'Prishtina, aty ku rrugët nuk kanë emër', sipas një kënge nga Bono dhe U2.

Wanderlust: A History of Walking, Solnit, R., botuar nga Viking, 2000

Kosovë: Udhërrëfyesi nga Bradt, Warrander, G., dhe Knaus, V., botuar nga udhërrëfyesit e udhëtimit nga Bradt, Bucks, 2007/2010

muhabete
kafeje

MBI TRASHËGIMINË
DHE DIVERSITETIN

JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe



JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

Funded
by the European Union



Implemented
by the Council of Europe

